

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

LIGJI NR. 2003/2

PËR MENAXHIMIN E FINANCEVE PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSITË

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të autoritetit të dhënë dhe përgjegjësive të transferuara në Institucionet e Përkohëshme të Vetë-qeverisjes (IPVQ) nga Rregullorja Nr. 2001/9 të 15 Majit e Misionit të Administratës së Përkohëshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi “Komizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohëshme në Kosovë” veçanërisht nenet 5.7, 9.1.1, 9.1.11, 9.1.26 (a), 9.3.3 dhe 11.2;

Si pasues të kompetencave të transferuara dhe të autoritetit të dhënë degës Ekzekutive të IPVQ-së nga Rregullorja e UNMIK-ut 2001/19 e 13 Shtatorit 2001, “Mbi Degës Ekzekutive të Institucioneve të Përkohëshme të Vetë-qeverisjes në Kosovë,” veçanërisht nenet 1.6, 1.7, 2.2 dhe 3.2 të saj, si dhe pikat (i), (ii), (iii), (iv), (v), (vii), (viii), (x), dhe (xi) të Shtojcës II të kësaj Rregulloreje;

Duke marrë parasysh kompetencat e rezervuara për PSSP-në nga Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9, veçanërisht nenet 8.1 (c), (e), (f), (r), (ë), dhe (x), si dhe Kapitulli 12 i saj, si dhe Rregullorja e UNMIK-ut 2001/19, me ndryshime, veçanërisht neni 7 e tutje;

Gjithashtu duke marrë parasysh Rregulloren e UNMIK-ut Nr.1999/1 të 25 Korrikut 1999, “Mbi Autoritetin e Administratës së Përkohëshme,” me ndryshime; dhe Rregulloren e UNMIK-ut Nr.1999/24 të 12 Dhjetorit 1999, “Mbi Ligjin në Fuqi në Kosovë”, me ndryshime; dhe

Duke njohur nevojën për themelimin e buxhetit, shpenzimeve kapitale dhe operative, menaxhimit financiar, kontabilitetit, përgjegjësive buxhetore dhe sistemit të raportimit financiar për organizatat buxhetore në Kosovë, për përshtetimin e pushteteve, kompetencave dhe detyrave të Ministrit të Ekonomisë dhe Financave rreth këtyre

çështjeve si dhe për vendosjen e një kornize për rregullimin e të ardhurave dhe granteve për komunat në Kosovë;

Miraton Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si vijon:

PËRMBAJTJA

| | |
|-----------|---|
| Pjesa I | Përkufizimet |
| Neni 1 | Përkufizimet e përgjithëshme |
| Pjesa II | Dispozitat e Përgjithëshme |
| Neni 2 | Ekzekutimi i kërkesave dhe i obligimeve |
| Neni 3 | Thesari |
| Neni 4 | Departamenti i Buxhetit |
| Neni 5 | Departamenti i Politikave Ekonomike |
| Neni 6 | Departamenti i Politikave dhe i Analizave Tatimore |
| Neni 7 | Departamenti Komunal i Politikave dhe Buxheteve |
| Neni 8 | Njësia e Revizionit të Brendshëm Financiar |
| Neni 9 | Departamentet dhe njësitë e tjera |
| Neni 10 | Paratë publike |
| Neni 11 | Drejtori Financiar dhe Zyrtari çertifikues |
| Neni 12 | Kushti i të drejtës për tu zgjedhur |
| Pjesa III | Mbledhja dhe ruajtja e parave publike |
| Neni 13 | Pranimi i parave publike |
| Neni 14 | Investimi i parave publike |
| Neni 15 | Shpenzimi i parave publike |
| Neni 16 | Llogaritë në Fondin e Konsoliduar të Kosovës |
| Pjesa IV | Përgatitja dhe përmbajtja e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës |
| Neni 17 | Përgatitja e propozimeve buxhetore (propozim-buxheteve) dhe kërkesave për përvetësime nga organizatat buxhetore për përvetësime |
| Neni 18 | Përgatitja dhe rishqyrtimi i përvetësimeve fillestare të propozuara buxhetore |
| Neni 19 | Përgatitja e Dokumenteve Buxhetore |
| Neni 20 | Rishqyrtimi i Buxhetit të Konsoliduar të Propozuar të Kosovës nga KEF-i |
| Neni 21 | Përvetësimet në mungesë të një Ligji vjetor mbi Përvetësimet |

| | |
|-----------------|---|
| Pjesa V | Ligjet dhe buxhetet e rishqyrtuara dhe të plotësuara të përvetësimeve |
| Neni 22 | Ligjet r rishqyrtuara të përvetësimeve dhe buxheteve |
| Neni 23 | Miratimi i ligjeve apo rregulloreve të reja që kanë nevojë për përvetësime |
| Pjesa VI | Rregullat për përvetësime |
| Neni 24 | Skadimi i përvetësimeve në fund të vitit fiskal |
| Neni 25 | Tarifat dhe detyrimet bankare |
| Neni 26 | Shpenzimet e rastit (të pa-parapara) |
| Neni 27 | Rregullimet e përvetësimeve të organizatës buxhetore |
| Neni 28 | Rregullimi i përvetësimeve në rast të ndryshimit të përgjegjësive të organizatës buxhetore |
| Neni 29 | Furnizimet nga agjensionet e tjera |
| Neni 30 | Blerjet në emër (interes) të një organizate tjetër buxhetore |
| Pjesa VII | Zotimet, fondet e akorduara, fondet e zotuara, fondet e obliguara dhe shpenzimet. |
| Neni 31 | Kontratat që vendosin përgjegjësi për bërjen e pagesave në vitin aktual fiskal apo në vitet e ardhëshme fiskale |
| Neni 32 | Fondet e akorduara |
| Neni 33 | Reduktimi i fondeve të akorduara |
| Neni 34 | Fondet e zotuara |
| Neni 35 | Pagimi |
| Neni 36 | Kompensimi i shpenzimeve |
| Pjesa VIII | Raportimi, kontabiliteti dhe revizioni |
| Neni 37 | Publikimi i ligjit mbi përvetësimet dhe publikimi i buxhetit |
| Neni 38 | Buxhetimi dhe regjistrat e kontabël në Thesar |
| Neni 39 | Regjistrat kontabël të organizatës buxhetore |
| Neni 40 | Raportet e përkohëshme buxhetore |
| Neni 41 | Raporti përfundimtar mbi buxhetin |
| Neni 42 | Revizioni financiar nga Revizori i Përgjithshëm |
| Neni 43 | Revizioni nga jashtë i Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës |
| Pjesa IX | Kufizimet në huamarrje, garantime, huadhënje dhe kapitalizimet |
| Neni 44 | Kufizimet e përgjithshme për huamarrjen, huadhënjen, lëshimin e instrumenteve të borxhit dhe garancioneve |
| Neni 45 | Përfundimet |
| Neni 46 | Huamarrjet e lejuara |

Pjesa X Përgjegjësitë e njësive të përcaktuara

| | |
|---------|--|
| Neni 47 | Përkufizimet |
| Neni 48 | Grantet për njësitë e përcaktuara |
| Neni 49 | Praktikat e kontabilitetit |
| Neni 50 | Raportet e përkohëshme |
| Neni 51 | Raportet vjetore |
| Neni 52 | Revizioni nga revizori i përgjithshëm |
| Neni 53 | Njoftimi i ministrave për ngjarjet e rëndësishme lidhur më njësitë e përcaktuara |
| Neni 54 | Informimi i vazhdueshëm i Ministrave |

Pjesa XI Shërbimet për të ardhurat

| | |
|---------|--|
| Neni 55 | Ligjet dhe Rregulloret e UNMIK-ut që rregullojnë shërbimet për të ardhurat |
|---------|--|

Pjesa XII Komunat

| | |
|---------|--|
| Neni 56 | Zbatimi i këtij ligji në komuna |
| Neni 57 | Grantet operative që i nënshtrohen këtij ligji |
| Neni 58 | Tatimet dhe tarifat e mbledhura nga komuna |
| Neni 59 | Komisioni i Granteve |
| Neni 60 | Grantet e përgjithshme operative |
| Neni 61 | Grantet specifike operative |
| Neni 62 | Caktimi i administratorit financiar komunal nga Ministri |

Pjesa XIII Dispozitat penale dhe çështjet finale

| | |
|---------|---|
| Neni 63 | Ndikimi i paligjshëm |
| Neni 64 | Shkeljet nga zyrtarët apo shërbyesve civil |
| Neni 65 | Suspendimi i zyrtarit publik dhe shërbyesve civil |
| Neni 66 | Shkeljet nga personat e tjerë |
| Neni 67 | Hyrja në fuqi |

Pjesa I **Përkufizimet**

Neni 1 **Përkufizimet e përgjithëshme**

1.1 Fjalët dhe shprehjet më poshtë, të shënuara në këtë ligj, do të kenë kuptimin e përshkruar në vijim, përveç nëse kontesti kërkon ndryshe:

“*Fondet e akorduara*” ka kuptimin që është përshkruar në nenin 32.1;

“*Përvetësimet*” domethënë “identifikimi i shumës maksimume në një Ligj për Përvetësimet, që mund të vihet në dispozicion gjat vitit fiskal për shpenzime nga një organizatë buxhetore për një qëllim të caktuar ose shpenzime kategorike”.

“*Ligji mbi përvetësimet*” nënkupton ligjin që miratohet nga Kuvendi dhe që i jep kompetenca organizatave buxhetore për të shpenzuar fondet publike, deri në një kufi të caktuar dhe për qëllime të caktuara, gjatë vitit fiskal.

“*Kuvendi*” ka kuptimin e institucionit ligjvënës të Vetë-qeverisjes, i themeluar sipas neneve 1.5(a) dhe 9.1.1. të Rregullorës së UNMIK-ut 2001/9 mbi “Kornizën Kushtetuese për Vetë-qeverisjen e Përkohëshme në Kosovë” dhe cilido Kuvendi pasues apo Autoriteti Qëndror Legjislativ;

“*Revizori i Përgjithshëm*” nënkupton postin e Revizorit të Përgjithshëm të Kosovës të krijuar si pasues të Rregullores së UNMIK-ut 2002/___;

“*BPK*” nënkupton Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës apo çdo institucion tjetër pasardhës të tij;

“*Komisioni Buxhetor*” nënkupton komisionin buxhetor të Kuvendit të përshkruar nga neni 9.1.11 i Rregullores 2001/9 “Mbi Kornizën Kushtetuese për Vetë-qeverisjen e Përkohëshme në Kosovë”.

“*Departamenti Buxhetor*” nënkupton departamentin që do të themelohet si pasues i nenit 4 të këtij ligji;

“*Organizatë Buxhetore*” do të thotë një autoritet publik, organ apo ndërmarrje që pranon një përvetësim.

“*Programi i Organizatës Buxhetore*” apo “*programi*” do të thotë një aktivitet apo të një grup aktivitetesh të organizatës buxhetore që kanë për qëllim të kontribuojnë në një varg të caktuar të synimeve të identifikuar publike;

“Zyrtari Çertifikues” domethënë “individit në një organizatë buxhetore që është i punësuar në bazë të nenit 11 të këtij ligji”.

“Drejtori Ekzekutiv Financiar” nënkupton, personin brenda organizatës buxhetore i cili është emëruar në këtë detyrë në përputhje me nenin 11 të këtij ligji;

“Të ardhurat e dedikuara” do të thotë paratë publike:

- (a) që i janë dhënë organizatës buxhetore për një qëllim apo qëllime të caktuara;
- (b) që mbliidhen në përputhshmëri me një ligj apo Rregullore të UNMIK-ut që përcakton se sa të holla duhet të shpenzohen;
- (c) të pranuar nga komuna dhe të përshkruara në nenin 58; apo
- (d) të pranuar nga një organizatë buxhetore në rrethanat e sqaruara në nenin 29.1(a).

“Njësitë e përcaktuara” nënkupton njësitë në Listën A të këtij ligji.

“Drejtori i Thesarit” nënkupton personin e identifikuar në nenin 3 të këtij ligji;

“KEF” nënkupton Këshillin Ekonomik dhe Fiskal të përshkruar në nenin 8.1(c), (r) dhe (x) të Rregullores 2001/9 mbi “Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë”;

“Rregullat financiare” do të thotë rregullat e lëshuara nga Drejtori i Thesarit dhe të miratuara nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave në përputhje me këtë ligj;

“Viti fiskal” do të thotë periudhën prej 1 Janarit të një viti deri më 31 Dhjetor të të njëjtit vit;

“Grantet e përgjithshme operative” do të thotë një shumë të përvetësuar në dobi të një Komune, që të shpenzohet nga komuna për qëllime të përgjithëshme publike;

“Qeveria” nënkupton Organin Ekzekutiv të IPVQ-së të themeluar në përputhje me nenet 1.5(c) dhe 9.3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/9 mbi “Kornizën Kushtetuese për Vetë-qeverisjen e Përkohëshme në Kosovë” dhe cilëndo Qeveri pasuese apo Autoritet Qëndror Ekzekutiv;

“Komisioni i Granteve” ka kuptimin e përshkruar në nenin 59;

“Udhëheqësi i Organizatës Buxhetore” nënkupton individin i cili mban pozitën më të lartë në një organizatë buxhetore;

“Buxheti i Konsoliduar i Kosovës” do të thotë buxhetin gjithpërfshirës të Kosovës për të gjitha organizatat buxhetore, që është konsoliduar në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare për financat Qeveritare.

“*Fondi i Konsoliduar i Kosovës*” nënkupton fondin që fillimisht është krijuar si pasues i Rregullores së UNMIK-ut 1999/16, me ndryshime, ose llogaritë apo grupin e konsoliduar të llogarive që është saktësuar më hollësisht në Regjistrin Llogaritar të Thesarit; me kusht që ky term të mos përfshijë ndonjë grant apo donacion nga një organizatë ndërkombëtare apo qeveri e huaj, kur granti dhe donacioni i tillë është lëndë e një kushti që nuk do të përfshihet në Fondin e Konsoliduar të Kosovës;

“*Komuna*” do të thotë njësinë territoriale të vetë-qeverisjes lokale në Kosovë që vepron nën autoritetin e Rregullorës UNMIK 2000/45 të 11 Gushtit, dhe cilëndo njësi pasuese e vetë-qeverisjes lokale në Kosovë;

“*Llogaritë zyrtare bankare*” do të thotë llogaritë apo nën-llogaritë bankare që janë krijuar nga drejtori i thesarit në BPK ose në një bankë tjetër të licencuar në Kosovë me qëllim të pranimit të parave publike;

“*Person*” do të thotë çdo person fizik apo juridik;

“*Autoritet Publik*” do të thotë secilën nga vijueset: një autoritetet qendror, rajonal, komunal apo lokal, organ publik, Ministri, department, autoritetet publik ose autoritet tjetër që vepron në bazë të një ligji, Rregulloreje të UNMIK-ut, udhëzimi administrativ, akti plotësues normativ që zbaton një ligj apo ndonjë kompetence tjetër ekzekutive, legjislative, rregullative, administrative-publike apo gjyqësore;

“*Grant Publik*” do të thotë një shumë të siguruar nga një organizatë buxhetore për një person, organ, organizate, apo ndërmarrje që është në përputhshmëri me synimet e organizatës buxhetore që e akordon atë grant;

“*Paratë Publike*” ka kuptimin e saktësuar në nenin 10.

“*Organizatë Buxhetore nën Kompetencat e Rezervuara*” nënkupton organizatat buxhetore që janë saktësuar në Listën 1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr.2002/23.

“*Administrata Tatimore*” nënkupton Administratën Tatimore të Kosovës e cila përmendet në nenin 55 të këtij ligji.

“*Thesari*” nënkupton thesarin e përshkruar në nenin 3 të këtij ligji.

“*Ndërmarrje*” nënkupton çfardo partneriteti, ndërmarrje të përbashkët, ndërmarrje, person juridik ose ndonjë organizatë apo institucion tjetër.

Pjesa II **Dispozitat e përgjithëshme**

Neni 2

Ekzekutimi i kërkesave dhe obligimeve

2.1 Të gjitha organizatat buxhetore gjatë udhëheqjes të çfarëdo aktiviteti ose gjatë ndërmarrjes së ndonjë veprimi që në menyrë direkte ose indirekte përfshin ose ndikon në përdorimin e fondeve publike ose burimeve publike, duhet të veprojnë në mënyrë të saktë dhe në përputhje të plotë me dispozitat e këtij ligji. Asnjë obligim që shfaqet si pasues i një dokumenti, marrëveshje apo rregulloreje nuk do të zbatohet ndaj një organizate buxhetore, fondi publik ose burimi publik nëse, dokumenti, marrëveshja ose rregulloreja e tillë e cila e paraqet obligimin në fjalë është përpiluar, pranuar apo përmbyllur në një mënyrë që dështon ti përmbushë kërkesat e parashtruara në dispozitat e këtij ligji,

Neni 3

Thesari

3.1 Thesari do të krijohet brenda Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, dhe është përgjegjës për menaxhimin e Fondit të Konsoliduar të Kosovës si dhe për ushtrimin e të gjitha përgjegjësisive që i janë caktuar në bazë të këtij ligji.

3.2 Thesarit do të udhëhiqet nga Drejtori, i cili emërohet nga PSSP-ja me këshillën dhe lejen e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa. PSSP-ja mund që të shkarkojë Drejtorin përkatës me këshillën dhe lejen e Ministrit të Ekonomisë dhe Financave në çdo kohë, duke - apo pa - e deklaruar arsyen për një shkarkim të tillë.

3.3 Drejtori i Thesarit do të asistohet nga Zvendës Drejtori, i cili emërohet nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave me këshillën dhe lejen e Qeverisë. Ministri i Ekonomisë dhe Financave mund të shkarkojë Zvendës Drejtorin përkatës në çdo kohë me këshillën dhe lejen e Qeverisë, duke - apo pa - e deklaruar arsyen për një shkarkim të tillë.

3.4 Drejtori dhe Zvendës Drejtori i Thesarit janë të obliguar që të raportojnë para PSSP-së, Qeverisë dhe Ministrit të Ekonomisë dhe Financave mbi të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me veprimtarinë e Thesarit dhe implementimin e Buxhetit të Konsolidur të Kosovës.

3.5 Nëse Thesarit synon që të ndërmarrë masa apo që të nxjerrë një vendim mbi një çështje me rëndësi domethënëse, masa apo vendimi i tillë duhet që paraprakisht të miratohet apo lejohet me shkrim nga Drejtori dhe Zvendës Drejtori. (Fraza “një masë apo vendim me rëndësi domethënëse” sipas kuptimit të këtij paragrafi nënkupton një masë apo vendim që ka të bëjë me (i) hartimin apo ndryshimin e procedurave administrative, (ii) transparencën apo mbikqyrjen e përdorimit të fondeve të donatorëve,

(iii) marëdhënjen ndërmjet thesareve qendrore dhe lokale, apo (iv) çfarëdo çështje tjetër që klasifikohet si çështje më rëndësi domethënëse nga PSSP-ja, Qeveria apo Ministri i Ekonomisë dhe Financave.)

Neni 4 Departamenti i Buxhetit

Në kuadër të Ministrisë për Ekonomi dhe Financa do të krijohet Departamenti i Buxhetit i cili është përgjegjës për (i) hartimin e Propozim Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, (ii) implementimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës si dhe (iii) ushtrimin e të gjitha përgjegjësisve të tjera të cilat i janë caktuar Departamentit të Buxhetit nga ky ligj.

Neni 5 Departamenti i Politikave Ekonomike

Në kuadër të Ministrisë për Ekonomi dhe Financa do të krijohet Departamenti i Politikave Ekonomike. Departamenti i politikave ekonomike është përgjegjës për përpilimin e parashikimeve makroekonomike dhe fiskale si dhe përcaktimin e parametrave të përgjithshëm të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe politikave afatmesme buxhetore. Pasi që të ketë kryer funksionet e tij të parashikimit dhe buxhetimit në mënyrë rutinore dhe të kënaqëshme, Departamenti i Politikave Ekonomike mundet që gjithashtu të bëhen analizat për rrezikun fiskal dhe plan-veprime nën programe të mëdha ta parashikimit.

Neni 6 Departamenti i Politikave dhe i Analizave Tatimore

Në kuadër të Ministrisë për Ekonomi dhe Financa do të krijohet Departamenti i Politikave dhe Analizave Tatimore ("Departamenti i Politikave Tatimore). Departamenti i Politikave Tatimore është përgjegjës për hartimin dhe propozimin e (i) legjislacionit që vendosin taksat, tarifa dhe detyrime dhe (ii) akteve plotësuese normative të nxjerrura si pasuese të atyre ligjeve. Departamenti i Politikave Tatimore është përgjegjës për vlerësimin e ndikimit fiskal të (i) tarifave dhe ngarkesave ekzistuese (ii) ndryshimeve të propozuara për taksat ekzistuese, tarifave dhe ngarkesave, dhe (iii) taksave të reja të propozuara, tarifave dhe ngarkesave të reja. Do të jetë gjithashtu përgjegjës për parashikimin dhe mbikqyrjen e të ardhurave tatimore dhe jo-tatimore si dhe për analizimin e çështjeve të tjera që kanë të bëjnë me politikave tatimore.

Neni 7Departamenti Komunal i Politikave dhe Buxheteve

Departamenti Komunal i Politikave dhe i Buxheteve do të formohet nën Ministrinë për Ekonomi dhe Financa. Departamenti Komunal i Politikave dhe i Buxheteve do të ushtrojë pjesërisht përgjegjësitë e Qeverisë të përcaktuara në nenin 5.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/9. Ky departament do t'u sigurojë mbështetje Komunave më qëllim që tu ndihmojë atyre në përmbushjen e obligimeve që u janë caktuar atyre sipas këtij ligji.

Neni 8Njësia e revizionit të brendshëm financiar

Në kuadër të Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, do të formohet njësia e revizionit të brendshëm financiar. Njësia e revizionit të brendshëm financiar do të bëjë revizionimin financiar të organizatave buxhetore në përputhshmëri me planin e punës që do të përcaktohet kohë pas kohe nga Ministria për Ekonomi dhe Financa në konsultim me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 9Departamentet dhe Njësitë e tjera

Ministri i Ekonomisë dhe Financave është i autorizuar që të themelojë departamente apo njësi të tjera përbrenda Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, nëse është e domosdoshme në mënyrë të arsyeshme për të ndihmuar Ministrinë në kryerjen e funksioneve dhe përgjegjësi të caktuara për Ministrinë sipas këtij ligji; me kusht që përgjegjësitë dhe funksionet e caktuara për secilin departament apo njësi të tillë, nuk do të jenë në konflikt me ndonjë dispozitë të këtij ligji.

Neni 10Paratë publike

10.1 Në këtë ligj, paratë publike kanë këtë kuptim:

- (a) para apo pasuri tjetër financiare nën përkujdesjen apo nën kontrollin e çfarëdo organizate buxhetore, përfshirë edhe paratë që mbahen nga Qeveria e Kosovës në dobi të ndonjë personi, organi, organizate apo ndërmarrjeje tjetër që nuk është organizatë buxhetore; dhe
- (b) para apo pasuri tjetër financiare që është nën përkujdesjen apo nën kontrollin e cilitdo personi, organi ose ndërmarrjeje që përkujdeset apo ushtron një kontroll të tillë për ose në emër të organizatës buxhetore.

10.2 Artikujt që shëndrrohen në para publike pas pranimit të tyre, përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në, të ardhurat e mbledhura nga organizata buxhetore nga:

- a) tatimet, tarifrat apo detyrimet e tjera;
- b) interesi (kamatat);
- c) dividendat apo pagesat e tjera nga njësitë në pronësi të organizatave buxhetore;
- d) të ardhurat nga shitja e çfarëdo prone;
- e) të ardhurat nga dhënia me qira e çfarëdo prone;
- f) të ardhurat nga lejet apo shitja e çfarëdo të drejte tjetër që përfshin një burim publik, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, të drejtën ndaj brezit frekuencor, eksplorimin apo eksplorimin e pasurive natyrore si dhe të drejtat mbi pronën intelektuale;
- g) qiratë apo privilegjet e pronarit;
- h) të ardhurat nga organizatat buxhetore;
- i) gjobat, pagesat rregullative, dëmtimet nga aktet civile, dhe të ardhurat nga sigurimi; dhe
- j) grantet apo donacionet nga organizatat ndërkombëtare, Qeveritë e jashtme apo çfarëdo burimi tjetër.

Neni 11

Drejtori Ekzekutiv Financiar dhe Zyrtari Çertifikues

11.1 Çdo organizatë buxhetore do të ketë Drejtorin Ekzekutiv Financiar dhe zyrtarin certifikues, të cilët do të emërohen nga sekretari i përhershëm i organizatës përkatëse buxhetore, nëse organizata buxhetore nuk ka sekretar të përhershëm, atëherë nga Drejtori Ekzekutiv. Asnjë individ nuk mund të shërbejë në më tepër se njërin nga vendpunimet e lartpërmendura.

11.2 Sekretari i përhershëm i një organizate buxhetore, ose nëse organizata buxhetore nuk ka sekretar të përhershëm atëherë, Drejtori Ekzekutiv do t'i sigurojë Ministrisë për Ekonomi dhe Financa një njoftim me shkrim, ku saktësohen emrat e individëve që janë emëruar të shërbejnë si Drejtor Ekzekutiv Financiar dhe Zyrtar Çertifikues, si dhe datat e emrimit të tyre.

11.3 Sekretari Permanent i një organizate buxhetore ose, siç mund të jetë rasti, Shefi Ekzekutiv, do të punsojë, në pajtim me udhëzimet të bëra nga Regullorja e UNMIK-ut 2001/36 të 22 dhjetorit 2001 "Mbi shërbimin civil të Kosovës" një mbikqyrës financiar dhe një zyrtar certifikues brënda tridhjet (30) ditëve nga dita efektive e këtij ligji. Nje pozitë e tillë duhet të përmbushet brënda tridhjet (30) ditëve nga dita që është hapur konkursi publik për një pozitë të tillë. Në rast se koha ka kaluar dhe nuk është përmbishur porti, atëher sekretari permanent i Ministrisë të Ekonomisë dhe Financave do të ketë të drejtën të emërojë një individ të shërbejë përkohësisht në postin e lirë.

11.4 Drejtori Financiar dhe Zyrtari Çertifikues do të përgjigjen para sekretarit të përhershëm të organizatës buxhetore ose nëse organizata buxhetore nuk ka sekretar të Përhershëm, atëherë para Drejtorit Ekzekutiv

Neni 12

Kushti i të drejtës për tu zgjedhur

12.1 Asnjë individ nuk lejohet që të shërbejë si drejtor apo zavendës drejtor i Departamentit të Thesarit ose Departamentit të Buxhetit, ose si Drejtor Financiar apo Zyrtar Certifikues i çfarëdo organizate buxhetore, nëse individi i tillë, gjatë dhjetë viteve të fundit është:

- a. Vendosur nga gjykata me jurisdiksion kompetent të ketë bërë një vepër penale apo civile që përfshin përgënjeshttrimin, prezantimin e rrejshëm, korupcionin, larjen e parave, përvetsimin, keqpërdorimin apo keqpërvetsimin e fondeve, ka qenë i përfshirë në mitosje apo ryshfet sipar ligjeve apo rregulloreve ne fuqi në Kosovë apo ndonjë vend tjetër, apo sipas konventave ndërkombëtare;
- b. përcaktuar nga një gjykatë, organ apo organizatë përgjegjëse për zbatimin e standardeve të sjelljes profesionale, se ka qenë i angazhuar në sjellje jo-profesionale; apo
- c. angazhuar në keqinterpretime materiale nën çfarëdo dëshmie nën betim apo betimi tjetër, ose dokumenti të vulosuar apo notarizuar.

12.2 Të gjithë individët që mbajnë apo janë duke aplikuar për një post të tillë do të betohen dhe do të vërtetojnë se ai/ajo kanë të drejtë të zgjedhen dhe se nuk u nënshtrohen përjashtimit për shkak të ndonjë arsyeje të përshkruar në nenin 12.1.

Pjesa III

Mbledhja dhe ruajtja e parave publike

Neni 13

Pranimi i parave publike

13.1 Asnjë organizatë buxhetore, person apo ndërmarrje nuk do të pranojë para publike, përveç nëse autorizohen saktësisht nga një ligj apo ndonjë Rregullore e UNMIK-ut.

13.2 Asnjë person apo ndërmarrje nuk mund të marrë para publike në emër të ndonjë organizate buxhetore dhe ti mbajë të njejtat në pritje të transferimit të tyre në një organizatë buxhetore, përveç nëse një person i tillë veçanërisht autorizohet që të bëjë një gjë të tillë nga:

- (a) drejtori i Thesarit, me shkrim; apo
- (b) një ligj apo Rregullore e UNMIK-ut.

13.3 Të gjitha të ardhurat e organizatës buxhetore duhet të depozitohen në një llogari zyrtare bankare në pajtim me Rregullat Financiare.

13.4 Personi i cili merr para publike (përfshirë këtu edhe ato para që pas pranimit shëndrrohen në para publike) duhet që medoemos t'i depozitojë ato me shpejtësi në një llogari zyrtare bankare brenda dy ditëve të punës, përveç nëse kërkohet ose autorizohet një periudhë tjetër kohore nga një ligj apo rregullore e UNMIK-ut.

13.5 Asnjë person, nuk do të pranojë para apo pronë nëse ai/ajo është duke u paraqitur (shtirë) se është me kompetenca zyrtare, përveç nëse saktësisht autorizohet nga një ligj apo Rregullore e UNMIK-ut.

Neni 14

Investimi i parave publike

14.1 Ministri i Ekonomisë dhe Financave, me miratimin paraprak nga Kuvendi dhe PSSP-ja mund të:

- (a) vendos kushtet dhe konditat që qeverisin investimin e parave publike; dhe
- (b) autorizojë Drejtorin e Thesarit që të:
 - (i) investojë para publike në instrumentet financiare në një afat jo më të gjatë se 1 (një) vit; dhe
 - (ii) likuidoj investimet e këtilla për të implementuar buxhetin ose qëllimet e tjera legjitime publike.

14.2 I gjithë interesi (kamata) dhe baza kryesore e pranuar nga investimet e bëra me paratë publike do të depozitohet në Fondin e Konsoliduar të Kosovës.

Neni 15

Shpenzimi i parave publike

15.1 Paratë publike do të përdoren vetëm për qëllime të miratuara publike. Asnjë organizatë buxhetore, person apo ndërmarrje nuk mund të devijojnë, keqzatojnë, ekspozojnë apo të përdorin në mënyrë të pa rregullt paratë publike.

15.2 Shpenzimet e parave publike mund të bëhen vetëm nga fondet e akorduara dhe vetëm në pajtueshmëri me procesin i cili është vendosur në përputhje me nenin 35, proces ky i vendosur nga Rregullat Financiare.

Neni 16
Llogaritë në Fondin e Konsoliduar të Kosovës

16.1 Drejtori i Thesarit do të krijojë dhe mirëmbajë llogaritë e Fondit të Konsoliduar të Kosovës si vijon:

- (a) një llogari për fondet që janë në dispozicion për përvetësim në komuna, që do të kenë formën e granteve të përgjithshme operative (që do të njihen si Llogari për Grantet e Përgjithëshme Operative), e që do të ndahet në nënllogari për secilën komunë;
- (b) një llogari për fondet që janë në dispozicion për përvetësimin e granteve operative specifike të komunave (që do të njihen si Llogari për Grante Specifike Operative). Kjo llogari do të ndahet në nën-llogari për secilën komunë;
- (c) një llogari për të ardhurat e dedikuara të komunave që vijnë nga (i) mbledhja e tarifave, ngarkesave dhe taksave, dhe (ii) grantet e përgjithshme dhe për qëllime të caktuara nga donatorët, (që do të njihet si Llogaria për të Ardhurat e Dedikuara Komunale); kjo llogari do të ndahet në nën-llogari për secilën komunë;
- (d) një llogari për të ardhurat e dedikuara të organizatave buxhetore, përveç komunave;
- (e) llogaritë në mirëbesim, siç janë të përshkruara në nenin 16.2; dhe
- (f) llogari të tjera që Drejtori i Thesarit mendon me arsye se janë të nevojshme për të arritur një qëllim legjitim publik.

16.2 Llogaritë në mirëbesim që përmenden në nenin 16.1(e) do të shfrytëzohen për paratë publike që një ose më shumë organizata buxhetore i mbajnë në mirëbesim për përfituesit e njohur apo të panjohur.

Pjesa IV

Përgatitja dhe Përmbajtja e Propozim-Buxhetit Vjetor të Konsoliduar të Kosovës

Neni 17

Përgatitja e Propozim-Buxheteve (propozimeve buxhetore) dhe kërkesave për përvetësime nga Organizatat Buxhetore

17.1 Deri më 15 Mars të çdo viti kalendarik, Ministri i Ekonomisë dhe Financave do të përpilojë vlerësime dhe parashikime për secilin nga tri vitet e ardhëshme të GDP-së mbi ndryshimin e nivelit të qmimeve, të ardhurat qeveritare nga taksat, detyrimet dhe tarifrat e tjera, fondet nga donatorët për Fondin e Konsoliduar të Kosovës si dhe informatat dhe të dhënat e tjera makroekonomike. Gjatë hartimit të vlerësimeve dhe parashikimeve të tilla, Ministri do të bashkëpunojë dhe do të konsultohet me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim.

17.2 Duke përdorur projektimet/vlerësimet e të ardhurave dhe fondeve që do të akordohen në të ardhmen nga donatorët, vlerësime këto që do të përpilohen në përputhshmëri me nenin 17.1, Ministri i Ekonomisë dhe Financave, në konsultim dhe bashkëpunim me KEF-it, FMN-në dhe Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, deri më 1 Prill të çdo viti kalendarik, do të caktojë kufirin (tavanin) e shpenzimeve të përgjithëshme nga Buxheti i Konsoliduar të Kosovës për secilin nga tre vitet vijuese fiskale. Ministri i Ekonomisë dhe Financave, deri më 1 Prill të çdo viti kalendarik, do të i'a dorëzojë tavanet e përgjithëshme të shpenzimeve PSSP-ës dhe KEF-it. Pas konsultimeve me KFE-in, PSSP-ja mund të ndryshojë propozim-tavanin përkatës të përgjithshëm të shpenzimeve dhe do të u'a shprehë atë anëtarëve të KEF-it.

17.3 Pasi që PSSP-ja të ketë vendosur tavanet e përgjithëshme të shpenzimeve në përputhshmëri me nenin 17.2, PSSP-ja deri më 20 Prill të çdo viti fiskal do të ndajë tavanin e përgjithshëm të shpenzimeve për vitin e ardhshëm kalendarik, në tavanin e përgjithshëm të shpenzimeve për organizatat buxhetore nën kompetencat e rezervuara (" Tavano i përgjithshëm i shpenzimeve për organizatat buxhetore nën kompetencat e rezervuara) dhe në tavanin e përgjithshëm të shpenzimeve për të gjitha organizatat tjera buxhetore (Tavano i përgjithshëm i shpenzimeve për organizatat jo të rezervuara). PSSP-ja do të bëjë ndarjen e tillë pas mbajtjes së konsultimeve me KEF-in.

17.4 Menjëherë pasi që maksimumi i përgjithshëm i shpenzimeve të jetë ndarë siç kërkohet nga neni 17.3: (i) Ministri i Ekonomisë dhe Financave do të konsultohet me Qeverinë dhe pasi që të ketë marrë udhëzime dhe direktiva nga Qeveria, do të përpilojë maksimumet e përgjithëshme të shpenzimeve për organizatat buxhetore që nuk janë nën kompetencat e rezervuara, dhe (ii) PSSP-ja , pasi që ka marrë këshillën e KEF-it, do të përpilojë maksimumin e përgjithshëm të shpenzimeve për sektoret nën kompetencat e rezervuara dhe do të i'a sigurojë ato Ministrin të Ekonomisë dhe Financave.

17.5 Ministri i Ekonomisë dhe Financave më 15 Prill të çdo viti kalendarik do t'u dërgojë të gjithë Drejtorëve Financiar të të gjitha organizatave buxhetore një doracak mbi buxhetin i cili siguron informata dhe udhëzime mbi metodologjinë dhe formatet të cilat do të përdoren nga organizatat buxhetore gjatë përgatitjes së propozim-buxheteve dhe kërkesave të tyre për përvetësime për vitin e ardhshëm fiskal, doracak mbi buxhetin do të përfshijë:

- (a) procedurat që duhet përdorur nga organizatat buxhetore gjatë përgatitjes së buxheteve të tyre dhe kërkesave të tyre për përvetësime;
- (b) informatat që nevojiten të parashtrihen në propozim-buxhet dhe në kërkesën për përvetësime;
- (c) detaje mbi formatin në të cilin duhet të përgatitet propozim-buxheti dhe kërkesa për përvetësime; dhe
- (d) afatin kohor, duke saktësuar datën, e cila nuk mund të jetë më vonë se 15 Qershori i vitit aktual kalendarik, sipas të cilit organizatat buxhetore duhet të përfundojnë dhe dorëzojnë në Ministrinë për Ekonomi dhe Financa propozim-buxhetet dhe kërkesat e tyre për përvetësime.

17.6 Drejtori Financiar i secilit organizatë buxhetore do të jetë përgjegjës për (i) përgatitjen e propozim-buxhetit dhe kërkesave për përvetësime të organizatës përkatëse buxhetore në përputhje me informatat dhe udhëzimet e parashtruara në doracakun mbi buxhetin , dhe (ii) dorëzimin e propozim-buxhetit dhe kërkesave për përvetësime tek Ministri i Ekonomisë dhe Financave, brenda afatit kohor të saktësuar në doracakun mbi buxhetin.

Neni 18

Përgatitja dhe rishqyrtimi i përvetësimeve fillestare të propozuara buxhetore

18.1 Pas skadimit të afatit kohor të saktësuar në doracakun mbi buxhetin, Ministri i Ekonomisë dhe Financave do të (i) rishqyrtojë propozim-buxhetet dhe kërkesat për përvetësime të dorëzuara nga organizatat buxhetore publike, (ii) këshillohet, nëse Ministri i Ekonomisë dhe Financave e sheh të arsyeshme, me një organizatë buxhetore mbi propozim-buxhetin e organizatës buxhetore në fjalë dhe kërkesat për përvetësime dhe (iii) përgatisë dhe shpërndajë tek çdo udhëheqës i organizatave buxhetore një përvetësim fillesar të propozuar buxhetor për një organizatë të tillë buxhetore.

18.2 Ministri i Ekonomisë dhe Financave, nëse shihet e arsyeshme, mund të këshillohet me një udhëheqës të një organizate buxhetore për të diskutuar dhe tentuar për të zgjidhur çfarëdo shqetësimi që ai apo ajo ka rreth propozim-buxhetit fillestar të përgatitur nga Ministria për Ekonomi dhe Financa për një organizatë të tillë buxhetore.

18.3 Gjatë gjithë kohës së përgatitjes së propozimeve fillestare të propozuara buxhetore, Ministri i Ekonomisë dhe Financave do të veprojë në përputhshmëri me maksimumet e përgjithëshme të shpenzimeve që vendosen nga nenet 17.3 dhe 17.4.

Neni 19

Përgatitja e Dokumenteve Buxhetore

19.1 Ministri i Ekonomisë dhe Financave, pas përgatitjes dhe shpërndarjes së përvetësimeve fillestare të propozuara buxhetore dhe pas këshillimit me udhëheqësit e organizatave përkatëse buxhetore, lidhur me shqetësimet mbi përvetësimet fillestare të propozuara buxhetore përkatëse, do të përgatisë dokumentet vijuese buxhetore për vitin e ardhshëm fiskal:

- (a) mesazhin buxhetor të Ministrisë; siç është përshkruar në nenin 19.3;
- (b) një mbishikim të buxhetit, siç përshkruhet nga neni 19.4;
- (c) planin mbi të ardhurat dhe shpenzimet, siç është përshkruar në nenin 19.5;
- (d) informatat mbi aktivën dhe detyrimet, siç përshkruhet në nenin 19.6;
- (e) një projektligj vjetor për rregullimin e përfitimeve të njëjësive të përcaktuara, për vitin e ardhshëm fiskal siç përshkruhet në nenin 19.7;
- (f) një projektligj vjetor mbi përvetësimet, siç përshkruhet në nenin 19.8;

- (g) një raport mbi zotimet dhe shpenzimet e planifikuara për të ardhmen, siç është përshkruar në nenin 19.9;
- (h) Deklaratën e Misionit dhe Planin për Ekzekutimin e Programit, siç përshkruhet në neni 19.10;
- (i) një plan për shpenzimet kapitale, siç përshkruhet në nenin 19.11; dhe
- (j) çfarëdo informata të tjera shtesë, të cilat Ministri i Ekonomisë dhe Financave i konsideron të nevojshme dhe adekuate.

19.2 Parashtrimi i informatave financiare siç janë, faturat, shpenzimet dhe financimi, në Buxhetin vjetor të Konsoliduar të Kosovës dhe formatin (formularët) e dokumentacionit duhet të jenë gjithpërfshirëse, transparente dhe në përputhje me Statistikat Financiare Qeveritare dhe klasifikimet e bazave të parave të gatshme që publikohen kohë pas kohe nga Fondi Monetar Ndërkombëtar.

19.3 Mesazhi buxhetor i Ministrisë të Ekonomisë dhe Financave për vitin e ardhshëm fiskal do të përfshijë:

- (a) një përshkrim të politikave financiare të Kosovës për vitin e ardhshëm fiskal;
- (b) një mbishikim të përgjithshëm të tipareve të rëndësishme të Propozim-Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës;
- (c) një shpjegim mbi çdo ndërrim të dukshëm në shpenzime apo arkëtime të bërë në vitin aktual fiskal; dhe
- (d) një shpjegim mbi çfarëdo ndryshimi të dukshëm të politikës financiare.

19.4 Mbishikimi i buxhetit do të përfshijë:

- (a) një mbishikim të ambientit makro-ekonomik vendor dhe ndërkombëtar në të cilin është përgatitur buxheti dhe rekomandime mbi strategjinë fiskale afat-shkurtër dhe afat-mesme;
- (b) synimet dhe prioritetet e buxhetit duke përfshirë vlerësimet e rëndësishme të arkëtimeve dhe shpenzimeve;
- (c) një përmbledhje të synimeve të programeve të organizatave buxhetore për të cilat përvetësimet janë propozuar;
- (d) një përshkrim të çfarëdo deficiti apo suficiti buxhetor të vitit aktual fiskal që pritet se do të bartet në vitin e ardhshëm fiskal;

- (e) nëse një deficit buxhetor pritet që të bartet në vitin e ardhshëm fiskal, atëherë gjithashtu duhet edhe një përshkrim mbi mënyrën e propozuar për financimin e një deficiti të tillë; dhe
- (f) një deklaratë eksplicite mbi supozimet ekonomike dhe të të ardhurave themelore buxhetore; dhe
- (g) çfarëdo informata të tjera që konsiderohen të nevojshme nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave.

19.5 Plani i arkëtimeve (të hyrave) dhe shpenzimeve do të përfshijë:

- (a) vlerësimet për vitin e ardhshëm fiskal dhe së paku për dy vitet vijuese fiskale, vlerësime të:
 - (i) të ardhurave të përgjithëshme të organizatave buxhetore në Kosovë, njëkohësisht duke përshkruar burimin e të ardhurave të tilla;
 - (ii) shpenzimeve të përgjithëshme
 - (iii) deficitit të përgjithshëm buxhetor apo suficitit nga viti aktual fiskal që pritet të transferohet në vitin e ardhshëm fiskal, arkëtimeve që priten në të ardhmen nga grantet e zotuar nga Qeveritë e jashtme apo organizatat ndërkombëtare; dhe
 - (iv) Të hyrat në të ardhmen nga grantet e zotuar nga Qeveritë e jashtme apo organizatat ndërkombëtare
 - (v) çfarëdo huaje në të ardhmen, duke përfshirë detajet mbi burimet e mundëshme dhe kushtet ne fuqi për fondet që do të huazohen
- (b) një vlerësim të të ardhurave të dedikuara që priten të pranohen gjatë vitit të ardhshëm fiskal;
- (c) numrin e miratuar të punëtorëve të përhershëm dhe të përkohëshëm të organizatave buxhetore që do të paguhet nga përvetësimet në vitin e ardhshëm fiskal;
- (d) vlerësimet e shpenzimeve të parashikuara për vitin e ardhshëm fiskal, lidhur me blerjet kapitale (të mëdha) që janë ndërmarrë gjatë viteve të mëparëshme fiskale apo që janë propozuar të ndërmirren gjatë vitit të ardhshëm fiskal;
- (e) detajet mbi të gjitha parashikimet për mbledhjen e tarifave të përdorimit (tarifës në shfrytëzim) për vitin e ardhshëm fiskal;

- (f) parashikimet detale të të gjitha arkëtimet nga njësitë e përcaktuara gjatë vitit të ardhshëm fiskal;
- (g) nën-shpenzimin e vlerësuar, i shprehur në dëftesë pagesat e mëparshme, i çdo dispozite të rregullës, vendimit, aktit tjetër nën-normativ ose kontratës që përcakton përjashtimin e rëndësishëm të tatimit, zbritjen apo koncesionin; shpenzimi i vlerësuar i çdo shume të parashikuar që do t'i ngarkohet organizatës buxhetore përgjegjës për zbatimin e programit, qëllimi i të cilit është të mbështetet nga dispozitat e tilla;
- (h) nën-shpenzimi i vlerësuar, i shprehur në dëftesë pagesat e mëparshme, i çdo dispozite të rregullës, vendimit, aktit tjetër nën-normativ ose kontratës që përcakton përjashtimin e rëndësishëm nga tatimi, zbritjen apo koncesionin; shpenzimi i vlerësuar i çdo shume të tillë të parashikuar do t'i ngarkohet organizatës buxhetore përgjegjës për nxjerrjen, administrimin ose zbatimin e rregullave përkatëse, vendimit, aktit nën-normativ ose kontratës në të cilën shfaqet dispozita e tillë.
- (i) qmimi i vlerësuar i të hyrave paraprirëse, të të gjitha të ardhurave të pambledhura nga taksat dhe zbritjeve nga taksat;
- (j) vlerësimet e çfarëdo shume monetare, të cilat priten të sigurohen nga organizatat ndërkombëtare apo Qeveritë e jashtme në dobi të Kosovës, të cilat nuk do të përfshihen në Fondin e Konsoliduar të Kosovës;
- (k) vlerësimet e ndihmave të çfarëdollojshme të siguruara nga organizatat ndërkombëtare apo Qeveritë e jashtme në dobi të Kosovës
- (l) çfarëdo informata të tjera që konsiderohen të nevojshme nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave.

19.6 Informatat mbi aktivën dhe detyrimet do të përfshijnë:

- (a) detajet e strategjisë së investimit të Qeverisë së Kosovës për paratë publike që do të investohen gjatë vitit të ardhshëm fiskal;
- (b) hollësitë e çdo huamarrje ekzistuese nga organizatat buxhetore dhe çdo huamarrje që organizatat buxhetore propozojnë për vitin e ardhshëm financiar, të propozura saktësisht dhe hollësisht në (i) informatat mbi aktivën dhe pasuritë të përshkruara në nenin 19.6 (b) të këtijë ligji dhe (ii) që janë siguruar në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.
- (c) hollësitë e shumës së vlerësuar të detyrimeve të paparashikuara të organizatave buxhetore, duke identifikuar saktësisht ato që kanë potencial që mund t'i japin shkas ngritjes së detyrimeve ekzistuese gjatë vitit të ardhshëm financiar;

- (d) vlerësime të hollësishme të borgjeve shumë-vjeqare
- (e) informata të tjera që konsiderohen të nevojshme nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave.

19.7 Ligji i propozuar vjetor mbi rregullimin e përfitimeve të njësive të përcaktuara do të përshkruajë përmasat sipas të cilave përfitimet (profitet) e çdo njësie të përcaktuar do të:

- (a) mbahen nga njësia, për përdorim periodik të fondeve për aktivitetet aktuale të saj;
- (b) mbahen nga njësia për investime kapitale nga e njëjta; apo
- (c) depozitohen në Fondin e Konsoliduar të Kosovës.

19.8 Ligji i propozuar vjetor i përvetësimeve do të parashtrrojë:

- (a) në rast të përvetësimit për një organizatë buxhetore:
 - (i) programin e organizatës buxhetore për të cilin është bërë përvetësimi; dhe,
 - (ii) kategorinë e shpenzimit përkatës; (kategorizimi i tillë do të bëhet në përputhje me rregullat të cilat qeverisin kategorizimet e tilla, rregulla këto që do të lëshohen nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave);
- (b) në rastin e përvetësimeve për pagesat që kanë të bëjnë me një borxh, siç përshkruhet në 46, shumën (nëse ka të tillë) e përvetësuar:
 - (i) për pagesën e interesit (kamatës) apo shumave të tjera që kanë karakter të interesit në hua;
 - (ii) për ripagimin e shumës kryesore të borxhit;
 - (iii) për pagimin e gjobave apo shumave të tjera që janë parashikuar për pagesë të vonuar, nëse ka të tilla; dhe
 - (iv) për pagesën e çfarëdo shume tjetër që ka të bëjë me borxhin, nëse ka të tillë; dhe
- (c) për përvetësimet e paparashikuara (të rastit) të cilat nuk kalojnë 5% të shumës së përgjithëshme të shpenzimeve.

19.9 Raporti mbi shpenzimet e zotuar dhe të planifikuara për ta ardhmen do të sigurojë:

- (a) detajet e çfarëdo obligimi kontraktues për vitin e ardhshëm dhe vitet e tjera fiskale, të përshkruara në nenin 31.2; dhe

- (b) detajet e të gjitha obligimeve nga programet jo-kontraktore të përshkruara në nenin 31.3.

19.10 Deklarata e Misionit dhe Plani i Ekzekutimit të Programit do të përfshijnë:

- (a) një përkufizim të misionit të secilit organizatë buxhetore.
- (b) një listë të qëllimeve që mund të maten, për të vlerësuar suksesin e një organizate buxhetore rreth përmbushjes së misionit të tij.
- (c) një përmbledhje të synimeve të programit, për çdo program madhor në buxhetin e propozuar të organizatës buxhetore; dhe
- (d) një deklaratë apo përshkrim të strategjisë së çdo organizate buxhetore për arritjen e qëllimeve dhe synimeve të tij, dhe
- (e) për secilin organizatë buxhetore, një listë të rregulloreve të UNMIK-ut, udhëzimeve administrative, ligjeve dhe akteve plotësuese normative të cilat duhet ti zbatojë organizata e tillë buxhetore.

19.11 Plani i Shpenzimeve Kapitale do të përfshijë:

- (a) një deklaratë që parashtron një plan afatgjatë për investime në Kosovë, i cili do të identifikonte dhe përfshinte nevojat më prioritare me nivele të arsyeshme shpenzimesh;
- (b) një program kapital që përmban projekte për vitin e ardhshëm fiskal dhe për dy vitet fiskale në vijim. Aq sa është e mundëshme, dhe duke identifikuar nevojat emergjente, programi kapital do të pasqyrojë prioritetet, projektet dhe nivelin e shpenzimeve të propozuara nga dokumentet buxhetore, në mënyrë që të sigurojë një mekanizëm për planifikim afatgjatë për tu përdorur nga Kuvendi dhe organizatat buxhetore;
- (c) një deklaratë të qëllimeve të secilit projekt;
- (d) një deklaratë mbi vendndodhjen, madhësinë dhe kohëzgjatjen e paraparë të projektit;
- (e) një vlerësim të shpenzimeve të përgjithshme të projektit, dhe të shpenzimeve për secilin vit të zbatimit të projektit;
- (f) burimin dhe llojet e fondeve të propozuara; dhe
- (g) vlerësimet mbi shpenzimet e vazhdueshme operative buxhetore apo kursimet që rezultojnë nga projekti, duke përfshirë edhe shpenzimet për personel dhe shpenzimet e mirëmbajtjes;

Neni 20

Rishqyrtimi i Propozim-Buxhetit vjetor të Konsoliduar të Kosovës

20.1 Ministri i Ekonomisë dhe Financave do ti parashtojë PSSP-së dhe KEF-it Propozim-Buxhetin vjetor të Konsoliduar të Kosovës të përgatitur sipas nenit 19 të

paktën njëzet e një (21) ditë përpara takimit të parë me KEF-in, ku do të shqyrtohet ai buxhet.

20.2 Në të njëjtën kohë derisa Ministri i Ekonomisë dhe Financave i dorëzon PSSP-së dhe KEF-it Propozim-Buxhetin vjetor të Konsoliduar të Kosovës, ai gjithashtu do t'u dërgojë udhëheqësve të secilit organizatë buxhetore informata që kanë të bëjnë me përvetësimin e propozuar buxhetor, për organizatën përkatëse buxhetore.

20.3 Nëse një udhëheqës i një organizate buxhetore kundërshton përvetësimin buxhetor për organizatën buxhetore të tij/saj në Propozim-Buxhetin vjetor të Konsoliduar të Kosovës ai/ajo mund ti dërgojë Ministrit të Ekonomisë dhe Financave një deklaratë me shkrim, duke saktësuar detajet për një kundërshtim të tillë: sidoqoftë, me kusht që deklarata e tillë të dorëzohet së paku katëmbëdhjetë (14) ditë para mbajtjes së mbledhjes së parë të KEF-së, në të cilën do të shqyrtohet Propozim-Buxheti vjetor i Konsoliduar i Kosovës.

20.4 Ministri i Ekonomisë dhe Financave do ti dorëzojë PSSP-së dhe KEF-it çfarëdo deklarate të pranuar nga ndonjë udhëheqës i një organizate buxhetore, në përputhje me nenin 20.3 së bashku me përgjegjet me shkrim të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë. Ministria për Ekonomi dhe Financa, do ti dorëzojë deklaratat e tilla dhe përgjegjet e tilla, nëse ka, tek PSSP-ja dhe KEF-i së paku shtatë (7) ditë pune para mbajtjes mbledhjes së parë të KEF-it në të cilën do të shqyrtohet Propozim-Buxheti vjetor i Konsoliduar i Kosovës.

20.5 Pas shqyrtimit të Propozim-Buxhetit vjetor të Konsoliduar të Kosovës të parashtruar sipas Nenit 20.1 dhe shkresave dhe përgjigjeve të parashtruara sipas Nenit 20, KEF-i do t'i japë Ministrit për Ekonomi dhe Financa një kopje të këshillave që i janë drejtuar PSSP-së mbi propozim buxhetin.

20.6 Duke vepruar në bazë të këshillave të KEF-it, PSSP-ja do të vendosë në ndonjë ndryshim në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës që ai e vlerëson të nevojshëm dhe t'ja drejtojë Ministrit për Financa dhe Ekonomi.

20.7 Në përputhje me vendimin e PSSP-së, Ministri i Ekonomisë dhe Financave do ti bëjë ndryshimet e përkatëse Propozim-Buxhetit vjetor të Konsoliduar të Kosovës, ligjit vjetor të propozuar mbi përvetësimet, ligjit të propozuar vjetor për rregullimin e përfitimeve të njësive të përcaktuara dhe dokumenteve të tjera buxhetore, siç kërkohet nga vendimet e tilla të mëparëshme. Ministri për Ekonomi dhe Financa pastaj, do t'ia prezantojë këtë dokument të modifikuar Qeverisë si dhe PSSP-së dhe KEF-it.

20.8 Qeveria pastaj formalisht do t'i dorëzojë Kuvendit, Propozim-Buxhetin vjetor të Konsoliduar të Kosovës, ligjin vjetor të propozuar për përvetësimet dhe ligjin vjetor të propozuar për rregullimin e përfitimeve (profiteve) të njësive të përcaktuara, të pranuar nga Ministria për Ekonomi dhe Financa. Qeveria do t'i transferojë dokumentet në fjalë

më apo para 30 Tetorit të vitit para vitit në të cilin dokumentet përkatëse do të hyjnë në fuqi.

Neni 21

Përvetësimet në mungesë të një Ligji Vjetor mbi Përvetësimet

21.1 Varësisht nga neni 21.2, nëse një Ligj Vjetor mbi Përvetësimet për një vit të caktuar fiskal nuk miratohet nga Kuvendi dhe nuk shpallet nga PSSP-ja para fillimit të vitit përkatës fiskal, ligji mbi përvetësimet i cili ka qenë në fuqi vitin e mëparshëm, do mbetet në fuqi (do të jetë aplikativ), Ligji mbi përvetësimet i cili ka qenë në fuqi vitin e kaluar do të trajtohet sikurse:

- (a) është shtyer për të mbuluar muajin e parë të vitit të tillë fiskal, dhe
- (b) ka siguruar një përvetësim për çdo organizatë buxhetore, që është i barabartë me (8.33 %) të përvetësimit të siguruar për organizatën e tillë buxhetore nga ligji i përvetësimeve.

21.2 Çdo përvetësim i autorizuar nga neni 21.1, do të pushojë së zbatuari në datën kur një Ligj i ri Vjetor i Përvetësimeve hyn në fuqi; dhe të gjitha shpenzimet e bëra nën autoritetin e përvetësimeve të autorizuara nga neni 21.1, do të trajtohen si shpenzime të bëra nën autoritetin e përvetësimeve të autorizuara nga Ligji i ri i Përvetësimeve.

Pjesa V

Ligjet e rishqyrtuara dhe të plotësuara të përvetësimeve dhe buxhetet

Neni 22

Ligjet e rishqyrtuara të përvetësimeve dhe buxheteve

22.1 Ministri i Ekonomisë dhe Financave mund të përgatisë amendamente për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe për ligjin mbi përvetësimet, që do të hyjnë në fuqi nëse ai/ajo ka mjaft arësye për të besuar se:

- (a) arkëtimet apo shpenzimet për vitin fiskal, do të jenë materialisht më të ulëta apo më të larta se ato që parashihen në ligjin e tillë për përvetësimet apo buxhetet; apo
- (b) Kuvendi me siguri do të ndryshojë apo anulojë një ligj ekzistues, apo do të miratojë një ligj të ri, dhe veprimet e tilla pritet që të ngrisin apo të reduktojnë arkëtimet apo shpenzimet për vitin aktual fiskal.

22.2 Procedura për përgatitjen e amendamenteve për një ligj vjetor mbi përvetësimet dhe Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës do të jetë e njëjtë me atë që është propozuar në Pjesën IV të këtij ligji; sidoqoftë, me kusht që dispozitat e vendosura në Pjesën IV, të cilat caktojnë datat e sakta në të cilat veprimet e caktuara duhet të ndërmerren, do të

injorohen. Duke marrë parasysh, që amendamentet e tilla të zbatohet vetëm për pjesën e mbetur të vitit fiskal, projektligji i rishqyrtuar do të sigurojë këtë.

Neni 23

Miratimi i ligjeve apo rregulloreve të reja që kanë nevojë për përvetësime

Kur, Qeveria është duke hartuar një projektligj për ta dorëzuar në Kuvend apo kur UNMIK-u përpilon një rregullore, dhe ligji apo Rregulloreja e tillë kërkon shpenzimin e parave publike në vitin fiskal në të cilin ligji apo rregulloreja e tillë hyn në fuqi, Qeveria apo UNMIK-u, siç është rasti, do të përgatisin një raport që tregojn vendin nga do të mirren fondet për shpenzimet e tilla shtesë, nga:

- (a) paratë publike të pa-përvetësuara që aktualisht ndodhen në Fondin e Konsoliduar të Kosovës;
- (b) të hyrat që priten gjatë pjesës së mbetur të vitit fiskal në të cilin Rregulloreja apo ligji i tillë miratohet; dhe/apo
- (c) paratë publike që janë përvetësuar aktualisht, por që do të jenë të pa-përvetësuara pas anulimit të një pjese të përvetësimit aktual.

Pjesa VI

Rregullat për përvetësime

Neni 24

Skadimi i përvetësimeve në fund të viti fiskal

Të gjitha përvetësimet për vitin fiskal do të skadojnë në mesnatën e 31 Dhjetorit.

Neni 25

Tarifat dhe detyrimet bankare

Të gjitha tarifat dhe detyrimet bankare të imponuara në lidhje me mirëmbajtjen ose përdorimin e llogarive zyrtare bankare apo menagjimin e investimeve të organizaave buxhetore, do të paguhet nga përvetësimet e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa.

Neni 26

Shpenzimet e Rastit (të pa-parapara)

26.1 Varësisht nga neni 26.2, nëse ndodh një rast urgjent i paparaparë, organizata buxhetore për të mbuluar shpenzimet e tilla, mund të aplikoj pranë Ministrisë për Ekonomi dhe Financa për fonde shtesë. Pas pranimit të atij aplikacioni, Ministria për

Ekonomi dhe Financa pasi që organizata buxhetore të ketë dhënë arsyetimet e nevojshme për veprimin e tillë, mund të heq një pjesë të fondeve të përvetësuar sipas ligjit të Përvetësimeve në fuqi për shpenzimet e rastit dhe atë pjesë të hequr të i'a shtojë përvetësimin përkatës të asaj organizate buxhetore.

26.2 Ministri i Ekonomisë dhe Financave mund të autorizojë shpenzime nga përvetësimet e pa-parashikuara (të rastit), të cekura në nenin 19.8 (c), në shumën e përgjithëshme deri në 250.000 EURO. Nëse kërkohet një shumë më e madhe se 250,000 EURO, atëherë Ministri i Ekonomisë dhe Financave duhet të marrë miratimin paraprak me shkrim nga Qeveria dhe PSSP-ja.

Neni 27

Rregullimet e përvetësimeve të organizatës buxhetore

27.1 Ministri i Ekonomisë dhe Financave, nëse merr një arsyetim të vlefshëm nga një udhëheqës i një organizate buxhetore, mund të autorizoj transferimin e një shume të caktuar nga një përvetësim i asaj organizate buxhetore në një përvetësim tjetër të organizatës së njëjtë; me kusht që, vlera e shumës së transferuar të mos jetë më e madhe se 20 % e përvetësimin të ndikuar negativisht.

27.2 Nëse udhëheqësi i organizatës buxhetore, kërkon nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave që të bëjë transferin e një shume që është më e madhe se njëzet përqind 20 %, por më e vogël se katërdhjetë përqind 40 % e përvetësimin të ndikuar negativisht, atëherë Ministri i Ekonomisë dhe Financave mund të autorizoj një transferim të tillë vetëm nëse ka marrë miratimin paraprak me shkrim nga Qeveria dhe PSSP.

27.3 Nëse udhëheqësi i organizatës buxhetore kërkon nga Ministri Finacave dhe i Ekonomisë që të autorizojë transferimin e një shume të barabartë me 40% apo më shumë, të përvetësimin të ndikuar negativisht, Ministri i Ekonomisë dhe Financave mund të autorizojë transferimin e tillë vetëm pasi të ketë marrë miratimin paraprak me shkrim nga Kuvendi dhe PSSP.

Neni 28

Rregullimi i përvetësimeve në rast të ndryshimit të përgjegjësive të organizatës buxhetore

Kur përvetësimi ndërlidhet me programin e organizatës buxhetore, programi i të cilit është transferuar në ndonjë organizatë tjetër buxhetore, Ministri i Ekonomisë dhe Financave mund të transferoj përvetësimin, siç kërkohet nga rrethanat, të gjitha apo një pjesë të përvetësimeve të tilla nga organizata e parë publik, në organizatën tjetër.

Neni 29

Furnizimet nga agjensionet e tjera

29.1 Kur një organizatë buxhetore pranon mallëra apo shërbime nga një organizatë tjetër buxhetore atëherë, organizata buxhetore që bën sigurimin e mallërave dhe shërbimeve mund të, (i) kërkoj nga organizata buxhetore që bën pranimin e mallërave dhe shërbimeve, që të paguaj në të njëjtën mënyrë sikur blerësit që nuk janë organizatë buxhetore ose, (ii) të bëj një rregullim të përvetësimeve, sipas mënyrës së saktësuar në nenin 29.3, të përvetësimeve të të dy organizatave buxhetore në shumën e njëjtë me vlerën në treg të mallërave dhe shërbimeve përkatëse:

29.2 Nëse pagesa bëhet sipas nenit 29.1 (i), atëherë të ardhurat do të regjistrohen si të ardhura të dedikuara të organizatës buxhetore që ka bërë furnizimin e mallrave apo shërbimeve.

29.3 Nëse agjensioni i cili furnizon me mallra apo shërbime, zgjedh rregullimin në përputhje me nenin 29.1 (ii) atëherë, organizata buxhetore së pari do të njoftojë Drejtorin e Thesarit në mënyrën e përshkruar nga Rregullat Financiare për një zgjedhje të tillë. Në rastet e tilla, vlera në treg e mallërave dhe shërbimeve të tilla, do të trajtohet si shuma e ngarkuar për blerje, do të trajtohet si shpenzim nocional nga organizata buxhetore blerëse dhe si rezultat do të ketë: (i) përvetësimi i bërë paraprakisht për organizata buxhetore blerëse, do të reduktohet nga shuma e shpenzimit nocional, dhe (ii) përvetësimi i bërë paraprakisht për organizatën buxhetore që furnizon me mallërat dhe shërbimet, do të rritet nga shumën e shpenzimit nocional.

Neni 30

Blerjet në emër (interes) të një organizate tjetër buxhetore

30.1 Kur një organizatë buxhetore aranzhon blerjen e mallrave apo shërbimeve që do të sigurohen në interes (të mirë) të ndonjë organizate tjetër buxhetore, organizata buxhetore e cila aranzhon blerjen do t'i paraqesë Drejtorit të Thesarit një njoftim për shpenzimin e deleguar duke treguar organizatën buxhetore në emër të të cilit është bërë përvetësimi.

30.2 Kur pagesa bëhet në bazë të njoftimit për shpenzimin e deleguar, siç pëshkruhet në nenin 30.1, shuma e paguar do të konsiderohet si pagesë prej fondeve të përvetësuara të organizatës buxhetore për të cilën është bërë blerja.

Pjesa VII

Zotimet, fondet e akorduara, fondet e zotuara, fondet e obliguara dhe shpenzimet

Neni 31

Kontratat që vendosin përgjegjësi për bërjen e pagesave në vitin aktual fiskal apo në vitet e ardhshme fiskale

31.1 Drejtori Ekzekutiv Financiar i një organizate buxhetore do të informoj Drejtorin e Thesarit për çdo kontratë të lidhur nga organizate buxhetore dhe për çfarëdo ndryshimi të ndonjë kontrate aktuale, nëse kontrata e tillë e obligon organizatë buxhetore që të bëjë pagesa gjatë vitit fiskal aktual apo gjatë viteve të ardhshme fiskale.

31.2 Drejtori i Thesarit do të mbajë shënime mbi çdo obligim pagese sipas kontratave të organizatës buxhetore të përshkruara me nenin 31.1 dhe mbi obligimet pagese jashtë-kontraktore të përshkruara në nenin 31.3.

31.3 Obligimi jashtë-kontraktor për pagesë, është obligimi për pagesë që kërkohet të përmbushet nga organizate buxhetore gjatë viteve të ardhshme, nëse programet ekzistuese të organizatës buxhetore do të vazhdojnë të financohen për ato vite të ardhshme në të njëjtin nivel dhe të njëjtën shtrirje, sikur për vitin aktual fiskal.

Neni 32

Fondet e akorduara

32.1 Kur është bërë përvetësimi për një organizatë buxhetore, Drejtori i Thesarit do të sigurojë organizatës përkatëse buxhetore autoritein për të bërë shpenzime nën atë përvetësim:

- (a) kohë pas kohe do të bëjë një akordim të fondeve nga të ardhurat në dispozicion në Fondin e Konsoliduar të Kosovës që duhet të shpërndahen nga përvetësimet e organizatës përkatëse buxhetore dhe do të njihen si “fonde të akorduara” nga ai përvetësim; dhe
- (b) do të përgatisë kohë pas kohe, një njoftimin për organizatën përkatëse buxhetore, ndërsa shumën e fondeve të akorduara ndryshon, duke saktësuar nivelin e fondeve që janë akorduar për shpenzim nga përvetësimi përkatës.

32.2 Shprehja “kohë pas kohe” në nenin 32, do të thotë jo më shpesh se në baza tremujore, përveç, në raste të veqanta, kur rrethanat ekonomike kërkojnë që Drejtori i Thesarit të sigurojë organizatës buxhetore autoritetin për t’i bërë disa shpenzime të caktuara në baza të përsheptuara.

32.3 Derisa fonde shtesë vihen në dispozicion për shpenzim në kuadër të përvetësimit, në të njëjtën kohë Drejtori i Thesarit do të bëjë akordime proporcionale të të ardhurave në përvetësim dhe do të njoftoj organizatën buxhetore për ndryshimet e tilla.

32.4 Njoftimi mbi fondet e akorduara do të mbetet në fuqi deri fund të vitit fiskal, përveç nëse ndryshohet më herët nga Drejtori i Thesarit.

Neni 33

Reduktimi i fondeve të akorduara

Drejtori i Thesarit mundet që në çdo kohë të zvogëlojë shumën e fondeve të akorduara nga përvetësimi nëse ai/ajo paraprakisht merr miratimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë. Ministri i Ekonomisë dhe Financave mund të miratojë një reduktim të tillë vetëm pasi (i) të përcaktojë se reduktimi i tillë është në interes të menaxhimit të mirëfilltë financiar, apo është i nevojshëm për të siguruar vazhdimësinë e shpenzimeve (fondeve në dispozicion) përgjatë gjithë vitit fiskal, (ii) të ketë dorëzuar një deklaratë në Qeveri dhe tek PSSP-ja duke parashtruar arësyet e sakta për marrjen e një vendimi të tillë dhe karakterin e saktë të reduktimit të propozuar, dhe (iii) të ketë pranuar një autorizim me shkrim nga Qeveria dhe PSSP-ja duke miratuar reduktimin e propozuar.

Neni 34

Fondet e zotuara

Drejtori i Thesarit do të përcaktojë një pjesë të fondeve, apo të gjitha fondet e akorduara në një organizatë buxhetore si fonde të zotuara kur fondet në fjalë jenë të nevojshme për përmbushjen e një obligimi nga viti aktual fiskal, respektivisht për pagimin e ndonjë obligimi kontraktues siç përshkruhet në nenin 31.1.

Neni 35

Pagimi

35.1 Nuk do të lejohen asfarë mjetesh nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për bërjen e pagesave kur nuk ekziston njoftimi për akordimin e fondeve faktike efektive që autorizojnë përdorimin e të hollave për bërjen e pagesave të tilla.

35.2 Procesi i cili do të ndiqet për bërjen e pagesave të autorizuara nga njoftimi për akordimin e fondeve, do të vendoset nga Rregullat Financiare.

35.3 Procesi i përmendur në nenin 35, do të zhvillohet në një menyrë që promovon decentralizimin maksimal të autorizim-pagesave në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare dhe kapacitetin administrativ të organizatave përkatëse buxhetore.

Neni 36
Kompensimi i shpenzimeve

36.1 Nëse gjatë vitit fiskal organizata buxhetore pranon një kompensim (kthim parash) për një shumë që është paguar nën autoritetin e përvetësimit për vitin e njëjtë fiskal, shpenzimi fillestar do të reduktohet nga shumata e kompensuar.

36.2 Nëse, gjatë vitit fiskal organizata buxhetore pranon një kompensim për një shumë e cila më parë është paguar nën autoritetin e përvetësimit për vitin e kaluar fiskal, kompensimi do të trajtohet thjeshtë si para publike.

Pjesa VIII
Raportimi, kontabiliteti dhe revizioni

Neni 37
Publikimi i ligjit mbi përvetësimet dhe publikimi i buxhetit

Brenda tridhjetë (30) ditëve pas miratimit nga Kuvendi dhe shpalljes nga PSSP-ja të Buxhetit vjetor të Konsoliduar të Kosoës dhe ligjit vjetor mbi përvetësimet, Ministri i Ekonomisë dhe Financave do përgatisë dhe publikojë buxhetin e tillë, dokumentet buxhetore, si dhe dokumentet e tjera sqaruese, në gjuhët zyrtare që përdoren për dokumentet e Qeverisë.

Neni 38
Buxhetimi dhe regjistrat kontabël në Thesar

38.1 Ministri i Ekonomisë dhe Financave do të vendosë sisteme klasifikimi për nevojat e buxhetit dhe regjistrimeve kontabël me qëllim që:

- (a) të ndihmojë në kontrollimin e shpenzimeve të organizatave buxhetore;
- (b) të lejojë analizat e zotimeve dhe shpenzimeve të organizatave buxhetore, sipas programit dhe kategorisë ekonomike në përputhje me sistemin klasifikues për para të gatshme të Entit Statistikor të Qeverisë të përcaktuara kohë pas kohe nga Fondi Monetar Ndërkombëtar; dhe
- (c) të lejojë analiza të tjera që Ministri për Financa dhe Ekonomi, i konsideron adekuate.

38.2 Ministria për Ekonomi dhe Financa do të mbajë në minimum, regjistrat kontabël për secilin organizatë buxhetore që tregon informatat e përgjithshme për secilën prej kategorive më poshtë, që në minimum duhet të përfshijnë vijueset:

- (a) arkëtimet e organizatës buxhetore;
- (b) detyrimet e papaguara të organizatës buxhetore;
- (c) pasuritë e organizatës buxhetore;
- (d) rregullimet e përvetësimeve;
- (e) përvetësimet që janë vënë në dispozicion për organizatën buxhetore për shpenzim me anë të njoftimeve për fondet e akorduara;
- (h) shtrirjet në të cilat fondet e akorduara të organizatës buxhetore janë shënuar si fonde të zotuarra; dhe
- (i) shpenzimet e bëra aktuale.

Neni 39

Regjistrat kontabël të organizatës buxhetore

39.1 Drejtori Ekzekutiv Financiar i organizatës buxhetore, do të regjistrojë të gjitha transaksionet dhe do të mbaj regjistrat kontabël në përputhje me Rregullat Financiare, si dhe të sigurojë kopjet e regjistrave kontabël për Ministrin e Financave dhe Ekonomisë.

39.2 Drejtori Ekzekutiv Financiar i një organizate buxhetore dhe Sekretari i Përhershëm i organizatës së tillë buxhetore (nëse organizata buxhetore nuk ka sekretar të përhershëm) atëherë Drejtori Ekzekutiv Financiar, tridhjetë 30 ditë pas mbylljes së çdo viti fiskal, do të sigurojë Drejtorit të Thesarit (i) një kopje të llogarive financiare të organizatës së tillë buxhetore për vitin përkatës fiskal dhe (ii) një konfirmim me shkrim se llogaritë financiare të organizatës buxhetore për vitin fiskal në fjalë, janë një pasqyrim i vërtetë dhe i saktë i financave dhe transaksioneve financiare të organizatës buxhetore për vitin përkatës fiskal.

39.3 Drejtori Thesarit, nëntëdhjetë (90) ditë pas mbylljes së çdo viti fiskal do të (i) bashkrëndojë llogaritë financiare sipas nenit 39.2. Llogaritë fiskale dhe balancet e parave të gatshme, dhe (ii) do t'i sigurojë Revizorit të përgjithshëm llogaritë financiare të të gjitha organizatave buxhetore.

39.4 Çdo organizatë buxhetore, do t'i dorëzojë raportin vjetor Ministrin të Financave dhe Ekonomisë brenda nëntëdhjetë (90) ditësh pas mbylljes së çdo viti fiskal, ky raport duhet të përfshijë:

- (a) një raportim mbi aktivitetet e organizatës buxhetore, përfshirë detajet e mallërave dhe shërbimeve që janë siguruar nga organizata buxhetore dhe përmasat e dallimit të mundshëm të ngarkuar për furnizim me mallëra apo shërbimeve cila ka qenë më e vogël, e barabartë, apo më e madhe se shpenzimet e përkatëse;

- (b) deklaratat financiare për vitin fiskal që paraqesin:
 - (i) përvetësimet e bëra për organizatën buxhetore për vitin fiskal;
 - (ii) detajet reale të shpenzimeve kapitale dhe operative të organizatës buxhetore për vitin fiskal; dhe
 - (iii) numrin e punëtorve të përhershëm dhe të përkohshëm në fillim dhe në fund të viti fiskal; dhe
- (c) një plan paraprak të menaxhimit, që parashtron planet detale të organizatës buxhetore për aktivitetet që do të ndërmerren në të ardhmen.

39.5 Organizata buxhetore do ti mbajë regjistrat kontabël dhe financiar për së paku 7 vite pas vitit fiskal për të cilin ato vlejné.

39.6 Ministri i Ekonomisë dhe Financave do t'i dorëzojë Kuvendit dhe PSSP-së raptrte mbi secilin organizatë buxhetore brenda tridhjetë (30) ditëve pasi që ato t'i jenë dorëzuar Ministrin të Ekonomisë dhe Financave.

Neni 40

Raportet e përkohshme buxhetore

Ministri i Ekonomisë dhe Financave do të përgatitë dhe Qeveria do të shqyrtojë raportet tre mujore që mbulojnë vitin fiskal për çdo çerek viti të përfunduar. Raportet e tilla do t'i parashtrohen Kuvendit dhe PSSP-së brënda tridhjetë (30) ditëve nga mbarimi i çdo çerek viti dhe të publikohen nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë.

Neni 41

Raporti përfundimtar mbi buxhetin

41.1 Ministri i Ekonomisë dhe Financave do të përgatisë dhe dorëzojë Kuvendit dhe PSSP-së por edhe do të publikojë:

- (a) jo më vonë se më 31 Mars të çdo viti kalendarik, raportin përfundimtar të buxhetit për vitin e kaluar fiskal; dhe
- (b) jo më vonë se më 30 Qershor të çdo viti kalendarik, një sërë deklaratash financiare të përpiluara nga Thesari e që janë në përputhje me standardet relevante ndërkombëtare të kontabilitetit të cilat janë revizionuar në përputhje me nenin 42.

- 41.2 Raporti përfundimtar buxhetor i përmendur në nenin 41.1, do të përmbajë:
- (a) informata të përgjithëshme buxhetore, të përshkruara nga neni 41.3;
 - (b) një raport mbi të ardhurat dhe shpenzimet, siç përshkruhet nga neni 41.4;
 - (c) informata mbi pasuritë dhe detyrimet, siç është përshkruar nga neni 41.5.
- 41.3 Informatat e përgjithëshme buxhetore do të përfshijnë:
- (a) një mbishikim të arkëtimit dhe shpenzimeve të rëndësishme;
 - (b) detaje mbi atë se si është financuar një deficit i mundshëm, apo si është investuar një suficit i mundshëm; dhe
 - (c) informata të tjera që konsiderohen të nevojshme nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave apo PSSP-ja.
- 41.4 Raporti mbi arkëtimet dhe shpenzimet do të përfshijë informatat në vijim:
- (a) arkëtimet aktuale, të ndara sipas llojeve, të organizatave buxhetore krahasuar me arkëtimet e parapara në buxhet;
 - (b) të ardhurat e dedikuara reale, të ndara sipas llojeve, të pranuar gjatë vitit fiskal;
 - (c) arkëtimet reale, të klasifikuara në baza ekonomike dhe programore, nga përvetësimet e të ardhurave të dedikuara;
 - (d) numrin aktual të punëtorëve të përhershëm dhe të përkohshëm të organizatave buxhetore që paguhen nga përvetësimet gjatë vitit fiskal;
 - (e) pagesat reale të interesit apo shumat e karakterit të interesit në borxhe siç përshkruhet nga neni 46 dhe për pagesën e borxhit kapital (fillestar);
 - (f) shpenzimet reale kundrejt çdo kategorie përvetësimi krahasuar me:
 - (i) përvetësimin buxhetor për atë kategori; dhe
 - (ii) shpenzimet e vërteta për atë kategori në vitin paraprak fiskal;
 - (g) detajet për çdo pranues të granteve publike të lëshuara gjatë vitit fiskal dhe shumat e grantit që është pranuar;
 - (h) detajet e shpenzimeve për përvetësimet për shpenzime të rastit siç përshkruhen në nenin 26;
 - (i) detajet e të gjitha rregullimeve të përvetësimeve të bëra në përputhje me nenin 27 dhe nenin 28;
 - (j) arkëtimet nga tarifatat për shfrytëzim gjatë vitit fiskal; dhe
 - (k) informata të tjera që Ministri i Ekonomisë dhe Financave apo PSSP-ja i konsideron të nevojshme.
- 41.5 Informatat mbi pasuritë dhe detyrimet do të përfshijnë:
- (a) detajet mbi investimet e parave publike të bëra gjatë vitit fiskal;
 - (b) detajet e çfarëdo obligimi të përshkruar në nenin 46;

- (c) një llogaritje të plotë të pasurisë në duar të organizatave buxhetoreve publike në fund të vitit fiskal; dhe
- (d) informatat të tjera të cilat Qeveria dhe Ministri i Ekonomisë dhe Financave apo PSSP-ja i konsideron të nevojshme.

Neni 42

Revizioni financiar nga Revizori i Përgjithshëm

42.1 Revizori i përgjithshëm do të pregatisë dhe t'i dorëzojë Kuvendit dhe PSSP-së një raport mbi deklaratat financiare të organizatave buxhetore për vitin e kaluar fiskal. Ky raport do të parashtojë opinionet e Revizorit të Përgjithshëm mbi atë se nëse deklaratat financiare të organizatave të tilla buxhetore pasqyrojnë në mënyrë të drejtë dhe korrekte financat e organizatave në fjalë.

42.2 Revizori i përgjithshëm do të ketë qasje të pakufizuar në të gjitha informatat dhe shpjegimet që për mendimin e tij/saj janë të nevojshme me qëllimin të ekzekutimit të revizionit financiar.

42.3 Revizori i përgjithshëm do të paraqesë një raport në përputhje me nenin 42.1 deri më 30 Qershor në vijim të vitit fiskal me të cilin ndërlidhet raporti.

42.4 Kopjet e raportit të Revizorit të Përgjithshëm do të vihen në dispozicion të publikut.

Neni 43

Revizioni nga jashtë i Buxhetit të Konsolidur të Kosovës

Asnjë dispozitë e këtij ligji nuk do të pengojë, dëmtojë apo nuk do të interpretohet në ndonjë mënyrë që pengon apo dëmton, pushtetin e rezervuar për PSSP-në sipas nenit 8.1 (e) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/9 për të bërë aranzhimet për një revizionim të jashtëm dhe të pavarur të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës.

Pjesa IX

Kufizimet në huamarrje, garantime, huadhënje dhe kapitalizimet

Neni 44

Kufizimet e përgjithshme për huamarrjen, huadhënjen, lëshimin e instrumenteve të borxhit dhe garancioneve

44.1 Asnjë organizatë buxhetore nuk do të bëjë çfardo kontrate, marrëveshje apo aranzhim që përfshin huamarrjen e të hollave apo themelimin e një mjeti kreditues në ndonjë mënyrë tjetër, përveç siç është shpjeguar saktësisht në këtë pjesë (Pjesa IX).

44.2 Asnjë organizatë buxhetore, (i) nuk mund të lëshojë asnjë instrument, siç mund të jetë ndonjë obligacion (instrument detyrimi) apo letërvlerë huamarrje kundrejt besueshmërisë (premtim i pagarrantuar pagese) duke vendosur kështu një obligim borxhi në organizatën buxhetore, (ii) nuk do të garantojë apo sigurojë efektshmërinë apo ripagimin e një borxhi apo obligimi të çfardo organizata buxhetore, personi apo ndërmarrjeje ose, (iii) të merret me çfarëdo aktiviteti huadhënës.

44.3 Asnjë organizatë buxhetore nuk mund t'i përdorë paratë publike ose burime apo fonde të tjera për të paguar apo blerë në mënyrë direkte apo indirekte, ndonjë interes në një ndërmarrje, dhe as që mund të bëhet ndonjë përvetësim për këtë qëllim.

Neni 45 Përfshirjet

Kufizimet e vendosura nga neni 44.1, nuk duhet të interpretohen si të zbatueshme mbi kontratat për prokurimin e mallërave, shërbimeve ose punëve të cilat janë shpërblyer nga organizata buxhetore, në pajtim me rregullat dhe procedurat e vendosura nga ligji në fuqi apo ndonjë rregullore të UNMIK-ut e cila qeveris (udhëheq) prokurimin publik.

Neni 46 Huamarrjet e lejuara

46.1 Nëse të gjitha kushtet dhe kërkesat e saktësuara në këtë nen 46 respektohen nga organizatat buxhetore, atëherë një organizatë buxhetore që ka për qëllim huamarrjen e parave për arritjen e një qëllimi të miratuar publik mund të marrë hua apo të bëjë ndonjë marrëveshje tjetër huamarrjeje me (i) një institucion financiar të saktësuar në Listën B të këtij ligji; (ii) me ndonjë institucion tjetër financiar, nëse lënda primare e një marrëveshjeje të tillë përfshin zgjatjen e një huamarrjeje apo themelimin e një mjete kreditues, apo të siguruar nga ndonjëri nga institucionet e sakëtuara në Listën B (iii) një bankë të licencuar për ushtrimin e aktivitetetve të huadhënjes, nëse banka e tillë është është zgjedhur në pajtim me rregullat në fuqi që qeverisin prokurimin publik në Kosovë.

46.2 Organizata buxhetore, mund të mirret me (angazhohet) aktivite të huamarrjes vetëm nëse qëllimi dhe shuma e huamarrjeve të tilla është propozuar saktësisht dhe hollësisht në informatat mbi aktivën dhe pasuritë të përshkruara në nenin 19.6 (b) të këtij ligji.

46.3 Para se ndonjë nga organizatat buxhetore të hyjë në çfardo kontrate, marrëveshje apo aktiviteti që përfshin huamarrjen e parave, Ministria për Ekonomi dhe Financa do të:

(i) njoftojë BPK-në mbi qëllimet e organizatës buxhetore për të marrë para hua si dhe shumën e kushteve materiale që mendohet se do të jetë e zbatueshme në huamarrjen e tillë, (ii) marrë pikëpamjet dhe këshillat me shkrim të BPK-së mbi huamarrjen e propozuar, (iii) të marrë pikëpamjet dhe këshillat me shkrim nga Departamenti i Bugjetor, Thesari dhe të Departamenti i Politikave Ekonomike të Ministrisë lidhur me huamarrjen e propozuar dhe (iv) të i'a prezentojë të gjitha pikëpamjet dhe këshillat e tilla Qeverisë dhe PSSP-së.

46.4 Pikëpamjet dhe këshillat e siguruar nga Ministri për Qeverinë dhe PSSP-në duhet që *në mes të tjerash* të sigurojë informata dhe plotësisht të marrin parasysh kufizimet e Euro-zonës për huamarrjet publike; veçanërisht kërkesat që shuma totale e borxhit publik të mos kalojë 60% të Prodhimit (Produktit) të Përgjithshëm të Vëndit të vitit të kaluar dhe që deficitin në buxhetin të mos kalojë 3% të PPV-së. Pikëpamjet dhe këshillat e siguruar nga Ministri gjithashtu, në mes tjerash do të sigurojë informatat, dhe plotësisht do të marrë parasysh ndikimet e çfarëdo ndryshimi të pafavorshëm që ka ndodhur që nga përgatitja e informatave të tilla mbi aktivën dhe pasuritë që përmenden në nenin 46.2 dhe 19.6 (b) mbi (i) kushtet dhe konditat financiare që me siguri se do të zbatohen kundrejt huamarrjeve të tilla apo (ii) qmimin e mallrave, punëve, pronave, shërbimeve apo të drejtave të përdormit që do të financiohen nga huamarrjet e tilla.

46.5 Pas marrjes së pikëpamjeve dhe keshillave që kërkohen nga neni 46.3 dhe 46.4, Qeveria dhe PSSP-ja do të miratojnë apo refuzojnë huamarrjet e propozuara për këtë. Nevojitet miratimi i të dyjave Qeverisë dhe PSSP-së. Qeveria dhe PSSP-ja nëse pajtohen, mundën që të miratojnë një shumë që do të huazohet dhe që është e ndryshme nga shuma e propozuar apo të imponojnë disa kushte të sakta mbi konditat financiare lëndë e të cilave do të jenë huamarrjet e tilla.

46.6 Organizata buxhetore që dëshiron të merret me çfarëdo aktiviteti që përfshin huamarrjen, do ta përdorë Ministrin e Ekonomisë dhe Financave si agjent të saj për ushtrimin e një aktiviteti të tillë.

46.7 Ministri i Ekonomisë dhe Financave do të jetë i vetmi agjent i autorizuar për të gjitha aktivitetet huamarrëse të organizatave buxhetore të Kosovës dhe do të: (i) prezentojë të gjitha organizatat buxhetore në ushtrimin e aktiviteteve të tyre huamarrëse; (ii) të udhëheqë të gjitha negociatat me huadhënësit e interesuar në emër të organizatave buxhetore; dhe (iv) të mbajë dokumentet origjinale dhe shënimet mbi të gjitha aktivitetet e huamarrjes.

46.8 Asnjë organizatë buxhetore nuk ka kompetenca që të përfshihet në ndonjë aktivitet të huamarrjes, siç është saktësuar nga neni 46. Nëse organizata buxhetore bën, pranon apo ekzekuton çfarëdo kontrate, marreveshje, ndërmarrje apo dokument që ka

huamarrjen si lëndë kryesore, atëherë një kontratë e tillë, marrëvshje, aktivitet apo dokument, do të anulohet dhe të shfuqizohet nëse nuk është autorizuar apo lëshuar në pajtueshmëri me nenin 46. Kur një organizatë buxhetore autorizohet që në përputhshmëri me këtë ligj të futet në marrëveshje për huamarrje, aktiviteti i tillë i huamarrjes duhet të bëhet në përputhshmëri të plotë me ligjin në fuqi në Kosovë.

Pjesa X **Përgjegjësitë e njësive të përcaktuara**

Neni 47 Përkufizimet

Në këtë pjesë:

“Drejtor” do të nënkuptojë anëtarin e organit më të lartë qeverisës të një njësie të përcaktuar; dhe

“Ministri Përgjegjës” nënkupton Ministrin që sipas një ligji apo Rregullore të UNMIK-ut është caktuar si përgjegjës për mbishikimin e përgjithshëm të njësisë përkatëse të përcaktuar, ose, nëse asnjë Ministër nuk është caktuar, Ministri i Ekonomisë dhe Financave do të jetë përgjegjës.

Neni 48 Grantet për njësitë e përcaktuara

48.1 Varësisht nga neni 48.2, organizata buxhetore mund të sigurojë një grant për një njësi të përcaktuar vetëm nëse një përvetësim për organizatën përkatëse buxhetore në mënyrë specifike dhe të saktë e autorizon një grant të tillë, dhe, në raste të tilla, organizata buxhetore do të sigurojë që çfarëdo kushti i vendosur nga përvetësimi në një grant të tillë të respektohet plotësisht.

48.2 Sa ka të bëjë me përvetësimet e propozuar që autorizojnë një grant për një njësi të përcaktuar, Ministri i Ekonomisë dhe Financave do: (i) të marrë pikëpamjet dhe këshillat e BPK-së mbi grantin e propozuar, (ii) të marrë pikëpamjet dhe këshillat me shkrim nga Departamenti i Buxhetit, Thesari dhe Departamenti i Politikave Ekonomike të Ministrisë lidhur me grantin e propozuar, dhe (iii) të i’a presentojë të gjitha pikëpamjet dhe këshillat e tilla Kuvendit. Gjatë marrjes në konsideratë të rekomandimeve (këshillave) për bërjen e një përvetësimi që autorizon grantin e propozuar, Kuvendi në mes tjerash do të marrë parasysh:

- (a) nëse njësia e përcaktuar apo qfarëdo akcioni në të shitet gjatë vitit fiskal
 - (i) mundësinë e investimeve kapitale (ii) kushtet dhe konditat operative të

cilat do ti viheshin pronarëve të rinj, në mënyrë që të arrihen qëlimet e barabartësisë;

- (b) planet biznesore të përgatitura nga njësitë e përcaktuara publike që paraqesin:
 - (i) tarifat e propozuara për konsumatorët, që do të vendon në vitin aktual dhe pesë vitet e ardhëshme fiskale;
 - (ii) kontratat dhe aranzhimet e tjera për ndërrimin e menxhmentit nëse tarifat e propozuara për konsumator nuk zbatohen sipas orarit të caktuar në planet e biznesit apo që vendosen por nuk zbatohen.

Neni 49

Praktika e kontabilitetit

49.1 Viti fiskal i një njësie të përcaktuar do të jetë viti kalendarik.

49.2 Njësia e përcaktuar do të mbajë llogarit dhe regjistra financiar në përputhje me dispozitat e Rregullorës 2001/30 të cilat janë aplikative për organizatat biznesore, llogaritë dhe regjistrat e tillë do të regjistrojnë në mënyrë të rregullt transaksionet dhe qëndrimet financiare. Njësia e përcaktuar do t'i mbajë llogaritë dhe regjistrat në mënyrë që të:

- (a) mundësojë përgatitjen e deklaratave financiare që kërkohen nga ky Ligj; dhe
- (b) lejojë që këto deklarata financiare të revizohen në mënyrë të mirëfilltë dhe të përshatëshme, ashtu siç parashihet me këtë ligj.

49.3 Njësia e përcaktuar duhet ti mbajë llogaritë dhe regjistrat financiar për së paku 7 vite pas përfundimit të transaksionit për të cilin ato vlejné.

49.4 Njësia e përcaktuar do t'i vëjë regjistrat në dispozicion në çdo kohë për inspektim apo revizionim nga cilido nga drejtorët e njësisë së tillë të përcaktuar.

Neni 50

Raportet e përkohëshme

50.1 Rregullat Financiare mund të përshkruajnë formën dhe klasifikimin që do të përdoret gjatë përgatitjes së raporteve të përkohëshme dhe përfundimtare të njësisë së përcaktuar.

50.2 Secila njësi e përcaktuar do të përgatisë një raport të përkohshëm për periudhat e përshkruara nga neni 50.3, ky raport do të përfshijë:

- (a) një raport mbi veprimtarinë; dhe
- (b) deklaratat financiare, përfshirë këtu edhe bilancin, deklaratat mbi profitin dhe humbjet, deklaratën e parave të gatshme në dispozicion dhe aktivën likuide, dhe deklaratat e tjera që japin një pasqyrim të drejtë dhe korrekt të statusit financiar të njësisë së përcaktuar.

50.3 Brenda tridhjetë ditëve (30) nga përfundimi i çdo qereku të vitit fiskal, njësia e përcaktuar do të përgatisë dhe do t'i dorëzojë Ministrit përgjegjës dhe Ministrit të Ekonomisë dhe Financave një raport të përkohshëm që mbulon vitin fiskal deri në përfundimin e qerekut përkatës të vitit. Ministri i Ekonomisë dhe Financave mundet, që pas kërkës (aplikimit) nga Ministri përgjegjës të autorizojë edhe një periudhë shtesë deri në tridhjetë (30) ditë për dorëzimin e raportit të përkohshëm pas.

50.4 Ministri Përgjegjës duhet të presentojë raportin e përkohshëm të njësisë së përcaktuar para Kuvendit brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve që nga dita kur raporti i është presentuar Ministrit Përgjegjës.

Neni 51 Raportet vjetore

51.1 Çdo njësi e përcaktuar duhet të përgatisë një raport vjetor që duhet të përfshijë:

- (a) një raport mbi veprimtarinë;
- (b) detajet e çfardo transakcioni të përshkruar nga neni 53 që është ekzekutuar nga njësia e përcaktuar gjatë vitit fiskal;
- (c) deklaratat financiare nga një revizor i pavarur, përfshirë këtu edhe bilancin, deklaratat mbi profitin dhe humbjet, dhe deklaratat e ngjajshme që japin një pasqyrim të drejtë dhe korrekt të statusit financiar të njësisë së përcaktuar; dhe
- (d) një plan paraprak menaxhimi, që parashton detajisht planet e njësive së përcaktuar për aktivitetet dhe aranzhimet e ardhshme.

51.2 Raporti vjetor i kërkuar nga neni 51.1 do të dorëzohet Ministrit Përgjegjës dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë brenda nëntëdhjetë ditësh (90) pas përfundimit të vitit fiskal të njësive së përcaktuar.

51.3 Ministri i Ekonomisë dhe Financave mundet që me kërkesën e Ministrit Përgjegjës të autorizojë një kohëzgjatje prej tridhjetë (30) ditësh shtesë për periudhën kohore të caktuar në nenin 51.2.

51.4 Ministri përgjegjës duhet të presentojë raportin vjetor të njësisë së përcaktuar para Kuvendit brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve që nda dita kur raportit në fjalë i është presentuar Ministrit Përgjegjës.

Neni 52

Revizioni nga Revizori i Përgjithshëm

Llogaritë, regjistrat dhe deklaratë financiare të çdo njësie të përcaktuar do të kontrollohen nga Revizori i Përgjithshëm. Revizori i Përgjithshëm do të dorëzojë një raport detal mbi rezultatet e një revizionimi të tillë në Kuvend deri më 30 Qershor të çdo viti kalendarik që vijon menjëherë pas vitit përkatës fiskal.

Neni 53

Njoftimi i ministrave për ngjarjet e rëndësishme lidhur me njësitë e përcaktuara

Nëse menagjerët apo drejtorët e një njësie të përcaktuar, propozojnë që të ndërmerret ndonjera nga veprimet vijuese, çdo drejtor i njësisë së përcaktuar menjëherë do ti sigurojë Ministrit Përgjegjës dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë detaje me shkrim mbi veprimin e propozuar:

- (a) formoj ose të marrë pjesë në formimin e një njësie ligjore, kompanie, shoqërie, trusti, sipërmarrje të përbashkët biznesore pa personalitet juridik, ndonjë marrëveshje të ngajshme, ose të tjera;
- (b) të kërkojë, ekspozojë apo të modifikoj karakterin apo përmasat e shtrirjes së çfarëdo interesi të mbajtur nga një organizatë apo shoqatë e përmendur në pikën (a);
- (c) përvetësimin apo rregullimin e çfarëdo pasurie operative apo të rëndësishme;
- (d) shuarjen, zgjerimin apo modifikimin e veprimtarive
- (e) ushtruar interesin pronësor ndaj cilëso prej organizatave apo shoqatave të përmendura në pikën (a), më lartë, për të nxitur një organizatë të tillë që të ndërmarrë veprimet e saktësuara nën pikat (a)-(d) më lartë; dhe
- (f) e angazhuar në çfarëdo aktiviteti huamarrës.

Neni 54

Informimi i vazhdueshëm i Ministrave

54.1 Drejtorët e një njësie të përcaktuar do t'i sigurojnë Ministrit Përgjegjës dhe Ministrit të Ekonomisë dhe Financave raportet, dokumentet dhe informatat e kërkuara nga cilido nga ata.

54.2 Çfarëdo raporte, dokumente apo informata që kërkohen nga neni 54.1, duhet të vihen në dispozicion sa më shpejtë që është e mundëshme pas kërkesës. Asnjë Drejtor, nuk mund të hezitojë që të plotësojë një kërkesë të tillë, për çfardo arsye.

Pjesa XI Komunat

Neni 55

Zbatimi i këtij ligji në komuna

55.1 Çdo komunë do të emërojë një Drejtor Ekzekutiv Financiar dhe do të krijoj një Departament të Thesarit dhe një Departament të Buxhetit të cilat do të kenë përgjegjësi dhe pushtet mbi proceset buxhetore të komunave, përgjegjësi këto të ngjajshme me ato që ushtrohen nga Thesari dhe Departamenti i Buxhetit i Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë mbi proceset buxhetore të Qeverisë së Kosovës.

55.2 Komuna mund të bëjë një marrëveshje me shkrim me Ministrin e Financave dhe të Ekonomisë që Ministri i Ekonomisë dhe Financave, Thesari dhe Departamenti Buxhetor të marrin përsipër të gjitha apo një pjesë të përgjegjësive mbi funksionet buxhetore të cilat komuna është e autorizuar ti ushtrojë sipas këtij ligji.

55.3 Varësisht nga neni 55.4:

- (a) procedurat e përgatitjes dhe zbatimit të buxhetit, të parapara në Pjesët IV-VII të këtij ligji si dhe procedurat e raportimit, kontabilitetit, si dhe procedurat revizore të përfshira në Pjesën VIII të këtij ligji do të zbatohen (ekzekutohen) nga komunat sikurse edhe dispozitat në ato Pjesë që kanë të bëjnë me punojësit, zyrtarët apo organizatat buxhetore do të interpretohen në mënyrë që kjo pjesë XII të mbulojë gjithashtu edhe zyrtarët përkatës të nivelit komunal, punojësit dhe autoritetet publike; dhe
- (b) çdo përgjegjësi, pushtet apo autoritet i përshkruar apo i imponuar në Pjesët IV-VIII mbi Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe çdo pushtet që ka Ministri kundrejt procesit buxhetor të qeverisë së Kosovës, do të interpretohet si përgjegjësi e njëjtë dhe pushtet i akorduar te Drejtori Ekzekutiv Financiar Komunal lidhur me procesin buxhetor komunal.

55.4 Kur Ministri i Ekonomisë dhe Financave e konsideron si të nevojshme, në përputhje me autoritetin e siguruar nga neni 5.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2001/9 dhe nenit 37.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/45, Ministri mund të parashtrijë (i) rregullat për përgatitjen e buxhetit dhe procedurat për zbatimin e tyre në komuna, të cilat dallojnë nga ato që përshkruhen nga pjesët IV dhe V të këtij ligji, dhe (ii) rregullat mbi raportimin, kontabilitetin dhe procedurat e revizionimit (kontrollit financiar) të komunave që dallojnë nga ato të përcaktuara me pjesën VIII të këtij ligji, duke siguruar që rregullat e

parashkruara nën autoritetin e këtij neni të hyjnë në fuqi vetëm pasi të jenë miratuar me shkrim nga komisioni i granteve.

55.5 Ministri i Ekonomisë dhe Financave mund të bëjë një marrëveshje me një komunë për ti siguruar asaj këshilla ose shërbime, në mënyrë që të sigurohet që fondet komunale nën fondin e konsoliduar të Kosovës të përdoren me efektshmëri.

Neni 56

Grantet operative që i nënshtrohen këtij ligji

Komuna mund të caktoj dhe të mbledhë tatime ose të pranojë grante të përgjithëshme operative ose grante specifike operative vetëm nëse ajo adopton (përvetëson) përgatitjen e buxhetit dhe procedurat e zbatimit dhe raportimit si dhe procedurat kontabël dhe të revizionit të përshkruara në nenin 55.

Neni 57

Tatimet dhe taksat e mbledhura nga komuna

57.1 Të gjitha të ardhurat e mbledhura nga komunat siç janë taksat, tatimet apo detyrimet e caktuara nga komuna janë para publike dhe menjëherë pasi të mblidhen do të depozitohen në llogarinë adekuate zyrtare bankare nën Fondin e Konsoliduar të Kosovës. Menjëherë pas krijimit të depozitave të tilla komuna do ta hartojë një shkresë Thesarin, në formularin e saktësuar në rregullat financiare, duke cekur (i) shumën e përgjithëshme të depozituar, dhe (ii) informatat e tjera që kërkohen sipas Rregullave Fiskale.

57.2 Përveç shumave të përshkruara nga neni 57.3 dhe neni 57.7, taksat, tatimet ose detyrimet e pranuar nga Komuna do të dedikohen si të ardhura, dhe do të trajtohen si fonde të përvetësuara në llogarinë e komunës në Fondin e Konsoliduar të Kosovës

57.3 Çdo taksë, tatim, ose detyrim i mbledhur nga komuna mbledhja e të cilit nuk është e autorizuar me ligj apo me rregullore të UNMIK-ut, do të trajtohet si para publike dhe do të depozitohet nga komuna në Fondin e Konsoliduar të Kosovës në përputhje me nenin 13 të këtij ligji. Shumat e përshkruara në këtë nen do të jenë, arkëtim i përgjithshme i Qeverisë dhe nuk do të dedikohen për një komunë por do të segregohen nga Drejtori i Thesarit dhe do të mbahen në një llogari të veçantë më qëllim që ti ofrojë komunës mundësi për të plotësuar kërkesat për kompensim, siç përshkruhet në nenin 57.5. Nëse pas pagimit të të gjitha kompensimeve me kohë dhe në mënyrë të vlefshme, mbeten ende shuma që janë segreguar, fondet e tilla do të bëhen të ardhura të përgjithshme.

57.4 Nëse një komunë dështon që të bëjë shpërndarjen e shumës ashtu si përshkruhet nga neni 57.3, Ministri i Ekonomisë dhe Financave do të përpilojë një vlerësim preliminar të shumave të përshkruara në nenin 57.3 që i ka mbledhur komuna. Ministri i Ekonomisë dhe Financave do të sigurojë një vlerësim preliminar për revizorin e përgjithshëm, i cili do ta shqyrtojë vlerësimin e tillë dhe do t'i dërgojë Ministrin vlerësimin përfundimtar duke

u bazuar në dëshmitë që i ka në dispozicion revizori i përgjithshëm. Ministri pastaj do të konsulohet me komisionin e granteve lidhur me çështjen dhe, nëse, komisioni i granteve e miraton, Ministri do të zvogëlojë shumën e përgjithshme operative të grantit të ndarë për atë Komunë në masën e përcaktuar nga vlerësimi përfundimtar.

57.5 Kur një person apo ndërmarrje që ka paguar një taksë, tatim apo detyrim siç është përshkruar në nenin 57.3 kërkon që t'i ripaguhet shumata e paguar, personi apo ndërmarrje në fjalë do të parashtrijë ankesën në fjalë brenda dy (2) viteve pas përfundimit të vitit kalendarik gjatë të cilit është paguar shumata përkatëse. Komuna përkatëse do ta bartë përgjegjësinë e vetme ligjore për kompensimin e taksës, tatimit apo detyrimit në fjalë, dhe asnjë autoritet publik nuk do të ketë asnjë përgjegjësi ligjore lidhur me atë se a është apo nuk është depozituar taksa, tatimi apo ngarkesa e paautorizuar në Fondin e Konsoliduar të Kosovës.

57.6 Çdo veprim apo vendim i komunës që ka për qëllim apo efekt ndalimin e ankesave ligjore për kompensimin e taksave, tatimeve apo detyrimeve të cilat janë imponuar apo mbledhur ilegalisht, apo ankesat legjitime për kompensimin e dëmeve që janë shkaktuar nga imponimi i tarifave apo tatimeve të tilla, aktet apo vendimet e tilla të komunës nuk do të jenë të vlefshme dhe as nuk do të hyjnë në fuqi.

57.7 Nëse taksat, tatimet apo detyrimet e përshkruara në nenin 57.1 janë mbledhur nga një komunë e cila sipas mendimit të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë dhe Revizorit të Përgjithshëm ka dështuar që të miratojë dhe zbatojë procesin buxhetor konform kërkesave të nenit 55, Ministria për Ekonomi dhe Financa do të sigurojë që taksat, tatimet dhe detyrimet e tilla të mos akordohen në llogarinë e fondeve të dedikuara për komunën përkatëse për në Fondin e Konsoliduar të Kosovës, por që në vend të kësaj ato të mbahen në një llogari mirëbesimi, siç parashihet me nenin 16.2 dhe të depozituara në llogarinë e fondeve të dedikuara të komunës përkatëse vetëm kur Ministri i Ekonomisë dhe Financave të verifikojë se komuna ka miratuar dhe zbatuar procesin buxhetor në përpunim me nenin 55.

57.8 Komuna që është ndikuar negativisht nga një vendim i Ministrisë për Ekonomi dhe Financa i marrë në përputhje me nenin 57.7, mund të përpilojë një kërkesë me shkrim dhe ta dërgojë kërkesën në fjalë tek Komisioni i Granteve për të shqyrtuar faktet dhe rrethanat që kanë shpjer drejt marrjes së vendimit të tillë. Komisioni i Granteve pas pranimit të kërkesës të tillë, mund të shqyrtojë çështjen në fjalë dhe të anulojë apo të mbështesë veprimin e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa. Nëse anulon vendimin e Ministrisë, atëherë do të lëshojë një vendim duke udhëzuar Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë që të marrë masa përkatëse, që janë të nevojshme për t'u siguruar se taksat, tatimet dhe ngarkesat e tilla të akordohen në llogarinë e të ardhurave të dedikuara të komunës përkatëse në Fondin e Konsoliduar të Kosovës.

Neni 58
Komisioni i Granteve

58.1 Komisioni i granteve do të themelohet jo më vonë se 60 ditë nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Anëtarët e të njejtit do të jenë Kryeministri, Ministri i Ekonomisë dhe Financave, një Ministër tjetër të caktuar nga Qeveria, Kryesuesi i Komisionit Buxhetor të Kuvendit dhe tre përfaqësues të komunave të caktuara nga Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe të miratuara nga Qeveria.

58.2 Komisioni i Granteve do të mbajë mbledhje në baza të rregullta. Mbledhjet do të organizohen nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave. Mbledhjet e tjera mund të organizohen bashkarisht nga dy anëtarë të tjerë, duke siguruar sidoqoftë që çdo mbledhje e tillë jo e rregullt të organizohet së paku shtatë ditë para mbajtjes së saj. Mbledhja e komisionit për grante do të jetë e vlefshme vetëm nëse (i) katër ose më tepër anëtarë janë të pranishëm (ii) njëri, ose Ministri i Ekonomisë dhe Financave ose Kryeministri janë të pranishëm. Ministri i Ekonomisë dhe Financave ose - në mungëse të tij – Kryeministri, do të jetë përgjegjës për drejtimin e mbledhjeve të komisionit për grante. Ministri i Ekonomisë dhe Financave do të formojë një sekretariat të përhershëm për të mbështetur komisionin e granteve gjatë ekzekutimit të përgjegjësive të tij.

58.3 Komision për Grante:

- (a) deri me 1 Gusht do t'i rekomandojë Ministrisë për Ekonomi dhe Financa shumat që duhet përvetësuar si grante të përgjithshme operative në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për tri vitet e ardhëshme fiskale;
- (b) deri me 1 gusht do të krijojë një formulë për shpërndarjen e fondeve të përvetësuar komuna si grante të përgjithshme operative;
- (c) kohë pas kohe do t'i rekomandojë Kuvendit përmes Ministrit të Financave dhe Ekonomisë se çfarë kompetencash duhet tu jepen Komunave, me qëllim të mbledhjes së tarifave, detyrimeve dhe taksave lokale;
- (d) deri me 31 gusht, së bashku me autoritetet publike qendrore përgjegjëse për mbikqyrjen e programeve të komunave për të cilat janë dhuruar grantet specifike operative (i) do t'i rekomandojë Ministrit të Financave dhe Ekonomisë shumat që duhet përvetësuar si grante specifike operative për ato programe; dhe (ii) të krijojë një formulë, duke u bazuar në kriterie objektive, për ndarjen e fondeve në formë të granteve specifike operative në komuna.

58.4 Nëse buxheti i konsoliduar i përgatitur nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave përfshinë një shumë që do të përvetësohet si grant i përgjithshëm operativ, e që nuk është i njejtë me shumën e rekomanduar nga neni 58.3 (a), Ministri do të përfshijë në dokumentet buxhetore një asyetim rreth ndryshimit në fjalë.

Neni 59Grantet e përgjithshme operative

59.1 Përvetsimi për grantin e përgjithshëm operativ, do të depozitohet në të ardhurat e dedikuara të komunës përkatëse në Fondin e Konsoliduar të Kosovës në katër kiste, në ditën e parë të punës të çdo qereku të vitit përkatës fiskal.

59.2 Nëse sipas mendimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe Revizorit të Përgjithshëm një komunë ka dështuar që të adoptojë dhe implementojë proceset buxhetore në përputhje me nenin 55, Ministria për Ekonomi dhe Financa mund të depozitojë të gjitha apo cilëndo nga keestet tremujore të saktësuara në nenin 59.1 në një llogari të mirëbesimit, siç është përshkruar në nenin 16.2, dhe jo në llogarinë e fondeve të dedikuara të komunës përkatëse në Fondin e Konsoliduar të Kosovës. Ministri i Ekonomisë dhe Financave mund t'i transferojë fondet e tilla nga një fond i tillë i mirëbesimit në llogarinë e fondeve të dedikuara të komunës, por kjo mund të bëhet vetëm kur Ministri i Ekonomisë dhe Financave të ketë konfirmuar se komuna i ka zbatuar dhe miratuar proceset buxhetore në përputhshmëri me nenin 55.

59.3 Komuna që ka pasur pasoja negative nga një vendim i Ministrisë për Ekonomi dhe Financa i marrë në përputhje me nenin 59.2, mund të arkivojë një kërkesë me shkrim dhe ta dërgojë kërkesën në fjalë tek Komisioni i Granteve për të shqyrtuar faktet dhe rrethanat që kanë shpjer drejt marrjes së vendimit të tillë. Komisioni i Granteve pas pranimit të kërkesë të tillë, mund të shqyrtojë çështjen në fjalë dhe të anulojë apo të mbështesë veprimin e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa. Nëse anulon vendimin e Ministrisë, atëherë do të lëshojë një vendim duke udhëzuar Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë që të marrë masa përkatëse, që janë të nevojshme për t'u siguruar se tarifat, tatimet dhe ngarkesat e tilla të akordohen në llogarinë e të ardhurave të dedikuara të komunës përkatëse në Fondin e Konsoliduar të Kosovës.

Neni 60Grantet specifike operative

60.1 Një përvetësim për grantin e përgjithshëm operativ do të depozitohet në llogaritë e të ardhurave të dedikuara të komunës në fondin e konsoliduar të Kosovës në katër kiste të barabarta, në ditën e parë të punës të çdo qereku të vitit përkatës fiskal.

60.2 Nëse autoritet publik qëndror i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e një programi të komunës, për të cilin është siguruar një grant specifik, siguron informata që komuna nuk është duke iu përmbajtur kushteve që qeverisin përdorimin e një granti të tillë, atëherë autoriteti qëndror publik do të njoftojë menjëherë Komisionin e Granteve. Komisioni për grante do të shqyrtojë çështjen, dhe nëse komisioni për grante zbulon se komuna nuk i është përmbajtur kushteve që qeverisin përdorimin e një granti special operativ, komisioni i granteve do të njoftojë menjëherë Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë mbi atë zbulim.

60.3 Pas pranimit të njoftimit nga komisioni i granteve se komuna nuk ka përmbushur kushtet që qeverisin grantet specifike, atëherë Ministria për Ekonomi dhe Financa mund të depozitoj në llogarinë e mirëbesimit të përshkruara në nenin 16.2; (i), të gjitha apo ndonjë pjesë të kesteve tremujore të përshkruara në nenin 60.1 dhe (ii) të gjitha ose ndonjë pjesë të kesteve tremujore të përshkruara në nenin 59.1, në vend që të depozitojnë fondet i tilla në llogaritë e të ardhurave të dedikuara të komunës në fondin e konsoliduar të Kosovës. Duke marrë parasysh, sidoqoftë, që para depozitimit të çfardo shume nga kestet tremujore të specifikuar në nenin 59.1, Ministri i Ekonomisë dhe Financave do të vlerësojë shumën e grantit specifik operativ i cili është përdorur në kundërshtim me kushtet që qeverisin përdorimin e tij, dhe duke siguruar më tutje që një vlerësim i tillë do të përmbajë shumën maksimale të fondeve që Ministria për Ekonomi dhe Financa në përputhje me klauzolën (ii) të fjalisë paraprake, mund të depozitoj në një llogari specifike të mirëbesimit.

60.4 Nëse autoriteti qendror publik është përgjegjës për mbikqyrjen e programin të Komunës që është prekur nga veprimet e ndërmarra nga Ministria për Ekonomi dhe Financa sipas nenit 60.3, vërteton Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë që Komuna ka demonstruar kapacitetet dhe vullnet që të përputhet me kushtet që qeverisin përdorimin e grantit specifik operativ, atëherë Ministri i Ekonomisë dhe Financave do të transferoj fondet nga llogaria përkatëse e mirëbesimit në llogarinë e komunës për fondet e dedikuara.

60.5 Komuna e cila është afektuar (prekur) nga një veprim i Ministrisë për Ekonomi dhe Financa i ndërmarrë në përputhje me nenin 60.3, mund ti bëjë komisionit të granteve një kërkesë me shkrim për shqyrtimin e fakteve dhe rrethanave që kanë pasur si rezultat ndërmarrjen e një veprimi të tillë. Komisioni i granteve mund që pas pranimit të një kërkesë të tillë, të shqyrtoj dhe të anuloj njoftimin e bërë Ministrisë së Financave sipas nenit 60.2. Nëse Komisioni i Granteve anulon një njoftim të tillë, atëherë Ministria për Ekonomi dhe Financa do të transferoj fondet nga llogaria e mirëbesimit në llogarinë e komunës përkatëse.

Neni 61

Caktimi i administratorit financiar komunal nga Ministri

61.1 Varësisht nga neni 61.2, kur Ministri i Ekonomisë dhe Financave vie deri tek përfundimi se komuna ka dështuar në miratimin e procesit buxhetor që është në përputhje me kërkesat e parashtruara nga neni 55, Ministri pas konsultimeve me komisionin për grante mund të caktojë një administrator të përkohshëm financiar në kuadër të Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, i cili do menaxhonte çështjet financiare të komunës.

61.2 Emërimi i tillë i bërë nën autoritetin e nenit 61.1 do të hyjë në fuqi vetëm nëse:

- (a) Ministri i Ekonomisë dhe Financave ka pranuar konfirmimin me shkrim nga Revizori i Përgjithshëm, se proceset buxhetore dhe financiare të

- miratuara nuk janë në përputhje me kërkesat e parashtruara nga neni 56;
dhe
- (b) vendimi për emërim është ratifikuar nga komisioni buxhetor i Kuvendit.

Pjesa XII

Dispozitat penale dhe çështjet përfundimtare

Neni 62 Ndikimi i paligjshëm

62.1 Do të konsiderohet vepër penale, për çdo person apo ndërmarrje që të sigurojë, të ofrojë, kërkojë, pranojë çfarëdo gjëje me vlerë për dobi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, të një të punësuarit apo ish të punësuarit të autoritetit publik apo të ndonjë zyrtarit publik apo të një ish zyrtarit publik, plotësisht apo pjesërisht, me qëllim të influencimit në një vendim lidhur me përdorimin e çfarëdo paraje publike.

62.2 Gjithashtu do të konsiderohet vepër penale për çdo person apo ndërmarrje që të ndërmarrë çfarëdo veprimi, ose të shpreh apo të tregojë gatishmëri që të marrë çfarëdo veprimi me qëllim të frikësimit, të shtrëngimit, të dëmtimit apo të nxitjes (fizike, financiare apo tjetër) ndaj çfarëdo personi apo ndërmarrësi tjetër plotësisht apo pjesërisht, me qëllim të ndikimit në një vendim lidhur me përdorimin e parave publike.

62.3 Çdo person apo ndërmarrje që dënohet për ndonjërin nga veprat penale të saktësuara në nenin 62.1 ose 62.2 do të paguaj dënimin prej 10,000 deri në 500,000 Euro, gjyqi përkatës do të përdorë diskrecionin e arsyeshëm me rastin e përcaktimit të shumave të sakta të dënimeve të tilla, duke marrë parasysh karakterin e saktë të veprës së tillë (përkatëse). Çdo person apo ndërmarrje e dënuar, gjithashtu, do të ndalohet që për një periudhë prej më së paku pesë (5) vjetëve të marrë pjesë në çfarëdo mënyre, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, në çfarëdo aktiviteti apo procedure që përfshinë përdorimin apo shpenzimin e parave publike apo burimeve të tjera publike. Nëse një person i tillë i dënuar është nëpunës i një autoriteti publik apo një zyrtar publik, ai ose ajo do të përjashtohet dhe do të ndalohet punësimi në institucionet e shërbimeve publike për një periudhë pesëvjeqare (5).

62.4 Çdo person i dënuar për ndonjërin nga veprat penale të saktësuara në nenin 62.2 do të burgoset me kohëzgjatje prej një viti apo me dyfishin e kohëzgjatjes së barabartë me kohëzgjatjen e cila është e zbatueshme sipas ligjeve të përgjithshme penale dhe rregulloreve në Kosovë për një vepër të tillë penale. Dënimi që është më afat-gjatë do të zbatohet.

62.5 Kur një vepër penale e saktësuar në nenin 62.1 ose nenin 62.2 supozohet se është kryer nga ose në emër të një ndërmarrje, personi fizik ose personat e përfshirë në ngjarjen e cila ka shkaktuar një kundravajtje të tillë, gjithashtu, do të ndiqen penalisht.

Gjithashtu, çdo drejtor apo zyrtar ekzekutiv përgjegjës i një ndërmarrje të tillë, i cili ka ditur apo është dashur të dijë ngjarjet që kanë paraprirë kundravajtjen e tillë, gjithashtu, do jetë përgjegjës penalisht.

Neni 63

Shkeljet nga zyrtarët apo nëpunësit publik

63.1 Nëse ndonjë zyrtar publik ose nëpunës publik me qëllim dështon, apo më shumë se një herë dështon me neglizhencë, t'u bindet një apo me tepër herë obligimeve dhe kërkesave të vendosura nga ky ligj apo një akt normativ ose urdhër të vlefshëm që është lëshuar nën autoritetin e këtij ligji, zyrtari i tillë publik apo nëpunësi do të përjashtohet dhe do t'i ndalohet punësimi në shërbimet publike për një periudhë së paku (3) trevjeçare.

63.2 Nëse ndonjë zyrtar publik apo nëpunës publik me qëllim dështon t'u bindet një apo më tepër obligimeve, apo kërkesave të vendosura nga ky ligj apo nga një akt plotësues normativ ose urdhër valid i lëshuar nën autoritetin e këtij ligji, personi i tillë do të jetë subjekt i një dënimi administrativ deri në 10,000 Euro. Nëse një dështim i tillë i qëllimshëm i shkakton dëme një organizate buxhetore dhe/ose humbje të parave publike, zyrtari i tillë publik apo shërbyesi civil do të jetë përgjegjës për të gjitha dëmtimet apo humbjet e tilla. Nëse një dështim i tillë përfshinë sjelljet që konsiderohen si një krim nën ligjet dhe rregulloret e pergjithshme penale të Kosovës, personi i tillë, gjithashtu, do të jetë subjekt i ndjekjes penale sipas ligjeve dhe rregulloreve të tilla.

63.3 Nëse ndonjë zyrtar publik apo nëpunës i një organizate buxhetore dështon me neglizhencë që t'u bindet një apo më tepër obligimeve, apo kërkesave të vendosura nga ky ligj apo nga një akt normativ ose urdhër i vlefshëm i lëshuar nën autoritetin e këtij ligji, dhe nëse një dështim i tillë i qëllimshëm i shkakton dëme një organizate buxhetore dhe/ose humbje të parave publike, zyrtari i tillë publik apo nëpunësi do të jetë përgjegjës për dëmtimet dhe humbjet e tilla, kur rrethanat përfshijnë neglizhencën ose pakujdesinë.

Neni 64

Suspendimi i zyrtarit publik dhe shërbyesve civil

Nëse një zyrtar publik apo nëpunës bëhet lëndë e një procedure gjyqësore ku janë shfaqur dyshimet se një zyrtar apo nëpunës i tillë ka qenë i përfshirë në një ngjarje të paligjshme, siç është përshkruar në nenin 62 ose ka dështuar me qëllim apo për shkak të neglizhencës t'u bindet një apo disa obligimeve apo kërkesave të vendosura nga ky ligj apo nga një akt apo urdhër plotësues normativ i lëshuar në mënyrë të vlefshme nën autoritetin e këtij ligji, gjyqi mund të lëshojë një urdhër me të cilin suspendon një person të tillë nga pozita e tij/saj deri në kohën kur gjyqi të mbajë një seancë të plotë dhe korrekte lidhur me dyshimet dhe të marë vendim.

Neni 65Shkeljet nga personat e tjerë

Nëse një person tjetër përveç zyrtarëve publik apo shërbyesve civil bën shkeljen e dispozitave të këtij ligjit apo të një akti ose rregullore normative, të lëshuar në mënyrë të vlefshme nën autoritetin e këtij ligji, personi i tillë do të jetë fajtor për vepër penale dhe do të kërkohet të paguajë një gjobë nga 10,000 deri në 500,000 Euro, gjyqi përkatës do të përdorë diskrecionin e arsyeshëm me rastin e përcaktimit të shumë së saktë të dënimeve të tilla, marrë parasysh karakterin e saktë të veprës së tillë. Nëse një shkelje e tillë i shkakton dëme një organizate buxhetore ose humbje të parave publike, personi i tillë do të jetë përgjegjës për të gjitha dëmtimet dhe humbjet e tilla. Nëse shkelja e tillë konsiderohet si një krim sipas ligjeve dhe rregulloreve të pergjithshme penale të Kosovës, personi i tillë, gjithashtu, do të ndiqet penalisht sipas ligjeve dhe rregulloreve të tilla.

Neni 66Hyrja në fuqi

Ky ligj do të hyjë fuqi në ditën e shpalljes nga PSSP-ja

Ligji nr. 2003/2

8 Maj 2003

Kryetari i Kuvendit të Kosovës

Akademik Nexhat Daci

Lista A
Njësitë e përcaktuara

Secila nga njësitë vijuese është një “njësi e përcaktuar” me nënkuptimin e kësaj fjale (i e përcaktuar) në mënyrën se si fjala e lartpërmendur përdoret në këtë ligj.

- 1) Posta dhe Telekom i Kosovës
- 2) Autoriteti i bankave dhe i pagesave të Kosovës
- 3) Autoriteti i Energjisë Elektrike të Kosovës
- 4) Autoriteti i Aeroportit të Prishtinës
- 5) Hekurudhat e Kosovës

Lista B
Institucionet ndërkombëtare finaciare

Në vijim gjinden institucionet ndërkombëtare finaciare të cilat janë të përmendura në nenin 46.1 të këtij ligji:

- 1) Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe anëtarët e tjerë të Bankës Botërore
- 2) Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
- 3) Fondi Monetar Ndërkombëtar
- 4) Banka Islamike për Zhvillim
- 5) Agjensionet zyrtare për ndihmimin (financimin) e eksportimit
- 6) Institucionet zyrtare finaciare bilaterale të vendeve të jashtme.